



**PËR AUDITIMIN TEMATIK “PËR VERIFIKIMIN E
ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË
AUDITIMET E MËPARSHME TË EVADUARA”
NË SUBJEKTIN**

PORTI DETAR SHA VLORE

Tiranë, Mars 2021





KONTROLI I LARËNË SHËNËT

PROJEKTRAPORTI PËR "PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË
LËNA NË AUDITIMET E MËPARSHME TË EVADUARA",
NË SUBJEKTIN PORTI DETAR SHA Vlorë

**PROJEKTRAPORTI I AUDITIMIT TEMATIK “PËR
VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA
NË AUDITIMET E MËPARSHME TË EVADUARA” PËR
PERIUDHËN 01.01.2020 DERI 30.06.2020 NË SUBJEKTIN**

Porti Detar SHA Vlorë

MARS 2021

Përmbajtja	faqe
PËRMBLEDHJE	3
I/1 HYRJA	5
I/2. OBJEKTI AUDITIMIT	5
I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:.....	5
I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT	5
I/5. KONKLZIONI:.....	5
II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE.....	6
III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM.....	6
IV KONKLZIONE DHE REKOMANDIME	41
ANEKSE	52

PËRMBLEDHJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në **Portin Detar SHA Vlorë** mbi “*Verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet për 6-mujorin e parë të vitit 2020*” për auditimin e kryer në vitin 2020, për periudhën 01.11.2017-31.12.2019 paraqitur me shkresën e administruara në KLSH me nr. 974/8 prot., datë 18.05.2020 (*administruar në subjekt me nr. 86/3 prot., datë 19.05.2020*), duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH^{së} të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2020, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:
 - a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
 - b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
 - c. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore;
 - d. vendimet për marrjen e masave administrative nga organet vendimmarrëse të përcaktuara me ligj, si IMTV, Komisioneve të Licencave, APP, e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, subjekti i audituar Porti Detar SHA Vlorë, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr. 85/42 prot., datë 09.06.2020, duke respektuar afatin 20 ditor. Në fakt konstatohet kjo shkresë nuk ka të detajuar planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve pasi nuk janë adresuar saktësisht problematikat sipas strukturave të Portit Detar SHA Vlorë.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecures së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

-Nga ana e subjektit të audituar nuk janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, veprim ky i cili është në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se:

“Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”,

III. Rekomandimet e KLSH

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr. 974/8 port., datë 18.05.2020 dhe në Portin Detar Vlorë me nr. 86/3 prot., datë 19.05.2020, janë rekomanduar gjithsej:

- a. Janë rekomanduar **34 masa organizative**;
- b. Janë rekomanduar **5 masa për shpërblim dëmi në vlerën 3,935,277 lekë**;

- c. Janë rekomanduar 1 masë në drejtim të të ardhurave të munguara në shumën 900,000 lekë;
- d. Janë rekomanduar 1 masë në drejtim të shmangies së paligjshmërisë në procedurat e prokurimit në shumën 32,007,674 lekë;
- e. Janë rekomanduar 4 masa për shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit në shumën 6,086,137 lekë;
- f. Janë rekomanduar 1 masë për shmangien e pagesave të kryera në mënyrë jo të rregullt (për punime të pakryera në fakt në momentin e likuidimit);
- g. Janë rekomanduar 2 masa administrative me gjobë dërguar PDV për aplikim nga IMT, Vlorë;
- g. Janë rekomanduar 3 masa administrative me gjobë dërguar APP;
- h. Janë rekomanduar 9 masa disiplinore;

IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH

Pas relacionit të hartuar nga znj. Nertila Përrallaj në cilësinë e Shefes së Shërbimeve të Brendshme dhe znj. Mestjona Banushaj në cilësinë e Shefes së Zyrës Juridike, sipas shkresës me nr. 181 prot., datë 18.05.2020, është marrë vendimi nr. 4 datë 03.06.2020, i administruar në Drejtori me shkresën nr. 181/3 prot., datë 03.03.2020, i Këshillit Mbikëqyrës i përbërë nga z. Arian Kraja Kryetar dhe znj. Erlis Hereni dhe z. Arvid Uruçi anëtarë. Sipas këtij vendimi i cili i është përcjellë KLSH sipas afatit 20 ditor nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit rezulton se pranueshmëria e rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar		Pa pranuar
			Plotësisht	* Pjesërisht	
1	Organizative	34	17	11	6
2	Shpërblim dëmi	5 3,935,277 lekë	5 3,935,277 lekë	0	0
3	Administrative rekomanduar PDV	2 persona	2 persona	0	0
4	Administrative rekomanduar APP	3 Persona	3 person	0	0
5	Disiplinore	9 persona	8	0	1
6	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	4 6,086,137 lekë	2 1,007,955	2 5,078,182	0
7	Të ardhura të munguara	1 900,000 lekë	1 900,000	0	0
8	Paligjshmëri në procedurat e prokurimit	1 32,007,674 lekë	0	0	1 32,007,674 lekë
9	Pagesa të kryera në mënyrë jo të rregullt	1 37,165,900 lekë	0	1 37,165,900 lekë	0

* **Shënim:** Statusi i pranimit si pjesërisht është cituar i tillë sipas përgjigjes së dhënë nga ana e subjektit të audituar me vendimin nr. 4, datë 03.06.2020 i administruar në Drejtori me shkresën nr. 181/3 prot., datë 03.03.2020 dhe si i tillë konsideruar i pranuar dhe në vijim është trajtuar zbatueshmëria e rekomandimit

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", si dhe manualit "Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve", miratuar me shkresën nr. 67, datë 23.06.2020 (nr. 341/17 prot., datë 36.06.2020).

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 251/1, prot., datë 11.02.2021 dhe njoftimit "Për fillim projekt auditimi tematik për zbatimin e rekomandimeve" nr. 241 prot., datë 11.02.2021, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:

1. Jonild Hoxhaj, (Përgjegjës grupi)
2. Ina Sokoli, anëtare
3. Artur Shehu, anëtar
4. Eduart Stafasani, anëtar.

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr. 974/8 prot., datë 18.05.2020, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që kanë lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLIZIONI:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Porti Detar SHA Vlorë në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja me shkresën nr. 974/8 prot., datë 18.05.2020, rezulton se nga 60 masa të rekomanduara (organizative, shpërblim dëmi, 3-E, të ardhura të munguara, Paligjshmëri në procedurat e prokurimit, Pagesa të kryera në mënyrë jo të rregullt administrative dhe disiplinore), janë pranuar nga subjekti në masën 52 masa ose 86.6 % dhe nuk janë pranuar 8 masa ose 22.6 %. Nga të pranuarat (52): janë zbatuar plotësisht 36, ose 69.2 % e tyre, janë zbatuar pjesërisht 10 masa ose 19.2 %, është në proces zbatimi 1 masë ose 1.9 % dhe janë pa zbatuar 5 masa ose 9.6 %. Nga sa shikohet niveli i realizimit në numër është në masën 69.2 %, por nisur nga fakti se problematika kryesore në lidhje me pagesat e kryera në mënyrë të parregullt nuk është zbatuar, tregon se Porti Detar SHA Vlorë nuk e ka vlerësuar plotësisht procesin e zbatimit të rekomandimeve.

Në mënyrë të detajuar tabela informuese me të dhënat e rekomandimeve të pranuar është si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar Plotësisht + Pjesërisht	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	28	19	5	0	4
2	Shpërblim dëmi	5 3,935,277 lekë	2 133,333	2 3,774,344 lekë	1 27,600 lekë	0

3	Administrative rekomanduar PDV	2 persona	0	2 persona	0	0
4	Administrative rekomanduar APP	3 persona	1 Person 50,000 lekë 2* Persona 0 lekë	0	0	0
5	Disiplinore	8 persona	8 persona	0	0	0
6	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	4 6,086,137 lekë	3 5,273,182 lekë	1 812,955 lekë	0	0
7	Të ardhura të munguara	1 900,000 lekë	1 900,000 lekë	0	0	0
8	Pagesa të kryera në mënyrë jo të rregullt	1 37,165,900 lekë	0	0	0	1 37,165,900 lekë

* *Sqarim: Shiko argumentimin e dhënë në kapitullin III/3, pika D. MASA ADMINISTRATIVE, D/1. Për Agjencinë e Prokurimit Publik.*

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Pavarësisht nga puna e bërë, ku niveli i zbatimit të rekomandimeve të pranuar është mbi 69.2 %, për disa nga masat Porti Detar SHA Vlorë nuk ka mundur ndjekjen e procedurave të duhura duke ndërprerë përpjekjet e tij për kryerjen e ndalesave, konkretisht, padive gjyqësore për arkëtimin e vlerave të rekomanduara.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

III/1-Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, “Porti Detar SHA Vlorë”, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr. 85/42 prot., datë 09.06.2020, Drejtori i Shoqërisë duke respektuar afatin 20 ditor. Në fakt konstatohet kjo shkresë nuk ka të detajuar planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve pasi nuk janë adresuar saktësisht problematikat sipas strukturave të Portit Detar SHA Vlorë.

Lidhur me mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Administratori i Portit Detar Vlorë SHA, z. **Admir Malaj**.

III/2-Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga ana e subjektit të audituar nuk janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, veprim ky i cili është në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku

përcaktohet se:

“Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”.

Lidhur me mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Administratori i Portit Detar Vlorë SHA, z. **Admir Malaj**.

Për sa më sipër është mbajtur aktkonstatimi nr. 1, datë 19.02.2021 dhe për çështjet e trajtuara, nga ana e subjektit të audituar z. **Admir Malaj**, në cilësinë e Administratorit të Portit Detar SHA Vlorë, është kthyer përgjigje sipas shkresës së administruar në KLSH me nr. 251/4 prot., datë 01.03.2021 dhe në Portin Detar SHA Vlorë me nr. 109/4 prot., datë 24.02.2021.

Pretendimet e subjektit të audituar:

“Vonesa e shkaktuar në raportimin 6-mujor ka ardhur për shkak të situatës së krijuar nga sëmundja e Titullarit të Institucionit me Covid-19. Gjithashtu, një pjesë e stafit ka kaluar situata të vështira personale nga Covid-19”.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH^{-së}:

Në lidhje me këtë çështje sqarojmë se Raporti Përfundimtar i Auditimit është nisur nga ana e KLSH sipas shkresës me nr. 974/8 prot., datë 18.05.2020, administruar nga ana e Portit Detar SHA Vlorë me shkresën nr. 86/3 prot., datë 19.05.2020. Afati përfundimtar i dorëzimit të raportimit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna ka qenë brenda 6-muajve, ose brenda datës 19.11.2020. Në gjykim të grupit të auditimit, mbështetur në kohën e mjaftueshme (6-muaj), pavarësisht situatës pandemike, duhet të ishin marrë masat për dërgimin e këtij raporti me qëllim respektimin e Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*, neni 30 Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2.

Për sa më sipër pretendimet tuaja mbi këtë pikë nuk qëndrojnë e si të tilla nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit.

III/3. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezultojnë si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i masave të marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, ka rezultuar se nga subjekti “Porti Detar”, Vlorë sha nuk janë pranuar 3 rekomandime, janë pranuar por nuk janë zbatuar 2 si dhe janë zbatuar por pjesërisht 5 rekomandime në kundërshtim me nenet 15 dhe 16 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të shtetit*. Konkretisht si në tabelën e më poshtme:

Rekomandime	Rekomanduar	Pranuar	Të pa pranuar	Realizuar	Realizuar pjesërisht	Në proces	Të pa zbatuara
Përmirësime ligjore	-	-	-	-	-	-	-
Masa organizative	17	17	-	8	5	3	1
Masa shpërbllim dëmi	6	5	1	3	-	2	1
M.D.ekonomik pamundësi arkëtimi	1	1	-	-	-	-	1
Masa për elimin.....	4	2	2	1	-	1	2
Masa disiplinore	12	12	-	12	-	-	-
Totali	40	37	3	24	5	6	4

Totali në %	93%	8%	60%	13%	15%	10%
-------------	-----	----	-----	-----	-----	-----

Në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë Porti Detar Vlorë janë pranuar 37 nga 40 rekomandime. Nga këto, 5 janë zbatuar pjesërisht duke mos përmirësuar plotësisht proceset e punës dhe për 1 rekomandim nuk është marrë ende asnjë masë për tu zbatuar.

1.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë Porti Detar SHA Vlorë, të marrë masa të menjëhershme për rishikimin dhe zbatimin e të gjitha masave të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH. Të rishikohen rekomandimet të cilat janë zbatuar pjesërisht, që nuk janë pranuar si dhe ato që janë pranuar dhe nuk janë zbatuar ende.

Menjëherë

Statusi i pranimit: **Pranuar (Pjesërisht)**¹

Në lidhje me këtë rekomandim nuk u vu në dispozicion asnjë dokument në lidhje me marrjen e masave nga ana e Këshillit Mbikëqyrës apo Drejtorit të Portit Detar SHA Vlorë. Në kushte të tilla ky rekomandim **konsiderohet i pranuar por i pa zbatuar**.

2. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga ana e Sekretarit të Këshillit Mbikëqyrës rezultoi se janë respektuar mënyra e mbledhjes së Këshillit Mbikëqyrës me përjashtim të dy rasteve për vitin 2018 për të cilat nuk disponohen në dosje njoftimet përkatëse të Administratorit të Shoqërisë, janë mbajtur procesverbalet përkatëse të mbledhjeve dhe janë firmosur nga anëtarët e këtij Këshilli. Gjithashtu, nuk disponohen CV e të gjithë anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, në kundërshtim kjo me Udhëzimin nr. 318, datë 8.4.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, kreu II, pika 2 (për periudhën para shfuqizimit të këtij akti).

2.1 Rekomandimi: Porti Detar Vlorë SHA të marrë masa për njoftimin paraprak të Anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës për zhvillimin e mbledhjeve.

Në vazhdimësi

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht dokumentit me nr. 62/1 prot., datë 31.01.2020 rezulton se është bërë kërkesa për mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës duke zbatuar rekomandimin e mësipërm. Në vijim zbatimi i këtij rekomandimi ngelet për tu verifikuar nga grupet e auditimit të KLSH-së. Në kushte të tilla **ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar plotësisht**.

3. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi Porti Detar Vlorë SHA nuk ka hartuar programe afatmesme dhe afatgjata ku të përcaktojnë deklaratat e vizionit dhe misionit të shoqërisë, qëllimet strategjike, analiza dhe parashikimi për përmirësimin e performancës, si dhe programe afatmesme e afatgjata për investimet kapitale, nevoja për të ardhura dhe analiza e tarifave/strategjitë e çmimeve, në kundërshtim me pikën I.2 të Udhëzimit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes nr. 394, datë 21.8.2014 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror” dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nr. 15, datë 2.5.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”.

¹ Statusi i pranimit si pjesërisht është cituar i tillë sipas përgjigjes së dhënë nga ana e subjektit të audituar me vendimin nr. 4, datë 03.06.2020 i administruar në Drejtori me shkresën nr. 181/3 prot., datë 03.03.2020 dhe si i tillë konsideruar i pranuar dhe në vijim është trajtuar zbatueshmëria e rekomandimit

3.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Portit Detar Vlorë SHA të marrin masa për organizimin e punës për hartimin e programeve afatmesme e afatgjata ku të përcaktohen, qëllimet strategjike, analiza dhe parashikimi për përmirësimin e performancës, si dhe investimet kapitale e nevoja për të ardhura.

Në vazhdimësi

Statusi i pranimit: Pranuar

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht dokumentit me titull *Programi i Zhvillimit Ekonomik për vitin 2021* rezulton se është hartuar ky dokument në përputhje me rekomandimin e dhënë. Në kushte të tilla **ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.**

4. Gjetje nga auditimi: Shpenzimet e raportuara në Këshillin Mbikëqyrës të Portit Detar Vlorë SHA për vitet 2017 dhe 2018 kanë mospërputhje me shpenzimet e paraqitura në pasqyrat financiare për vitet përkatëse. Kjo pasi për vitin 2017 në pasqyrat financiare totali i shpenzimeve është 152,971,847 lekë, ndërsa në Analizën e realizimit të programit ekonomik 2017 totali i shpenzimeve është 154,365,600 lekë. Ndërsa për vitin 2018 në pasqyrat financiare totali i shpenzimeve është 124,269,270 lekë, ndërsa ai i paraqitur në Analizën e realizimit të programit ekonomik 2018 është 150,543,000 lekë. Treguesit e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të paraqitura në analizat e realizimit të programeve ekonomike për të tre vitet paraqiten me ulje, ku për vitet 2018 dhe 10 mujorin e parë të vitit 2019 shpenzimet e realizuara i tejkalojnë të ardhurat. Përkatësisht për vitin 2018 tejkalimi i të ardhurave paraqitet në vlerën 25,186,000 lekë ndërsa për 10 mujorin e parë të vitit 2019 tejkalimi i të ardhurave është në vlerën 3,278,000 lekë. Sa më sipër ka rezultuar se nga ana e shoqërisë nuk janë bërë analiza dhe vlerësime të hollësishme tekniko-ekonomiko-financiare mbi nevojat dhe pritshmërinë reale të punës duke bërë që zbatimi i programeve ekonomiko-financiare të jetë në kundërshtim me parimet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe eficiencës. Në analizat e realizimit të programeve ekonomike për vitet 2017 dhe 2018 paraqiten gjithashtu tejkalime të pa miratuara të zërave të shpenzimeve specifikisht për pagesat e Këshillit Mbikëqyrës, energjisë elektrike, siguracioneve, për zërat pritje përcjellje, amortizime dhe fondit për të përndjekurit.

Nga auditimi i planifikimit të zërit “shpenzime personeli” në Programin Ekonomik të hartuar nga Zyra e financës për vitet 2017, 2018 dhe 2019 rezultuan diferenca të konsiderueshme midis shpenzimeve të planifikuara dhe atyre të realizuar. Konkretisht:

Për vitin 2017: Në programin ekonomik të miratuar shpenzimet e personelit ishin 118,438,000 lekë ndërkohë që shpenzimet e realizuara ishin 107,919,624 lekë. Nga ku vihet re një diferencë prej 10,518,376 lekë shpenzime të mbi planifikuara personeli.

Për vitin 2018: Në programin ekonomik të miratuar shpenzimet e personelit ishin 121,606,307 lekë ndërkohë që shpenzimet e realizuara ishin 110,245,154 lekë. Nga ku vihet re një diferencë prej 11,361,153 lekë shpenzime të mbi planifikuara personeli.

Për vitin 2019: Në programin ekonomik të miratuar shpenzimet e personelit ishin 109,219,194 lekë ndërkohë që shpenzimet e realizuara ishin 103,804,000 lekë. Nga ku vihet re një diferencë prej 5,415,194 lekë shpenzime të mbi planifikuara personeli.

Nga sa më sipër, mund të shprehemi me rezervë për planifikimin dhe analizimin e zërit të shpenzimeve për paga gjatë hartimit të programimit ekonomik të shoqërisë. Duke sjellë kështu një programim jo të saktë dhe të argumentuar mirë për zbatimin e numrit mesatar të punonjësve dhe fondit të pagave. Projekt programi i vitit 2018 nuk është miratuar në Këshillin Mbikëqyrës dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë brenda afatit të përcaktuar në Udhëzimit të Ministrisë

së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes nr. 394, datë 21.8.2014. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në cilësinë e ministrisë së linjës administrative për Portin Detar Vlorë SHA, nuk ka shprehur qëndrimet e saj lidhur me treguesit kryesorë të programit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin*", neni 5. si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes nr. 394, datë 21.8.2014 "*Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror*".

4.1 Rekomandimi: Drejtori i Portit Detar Vlorë SHA të marrë masa për eliminimin e praktikave të deritanishme lidhur me formalitetin e procedurave të miratimit dhe pasaktësive që shoqëronin këtë proces.

4.2 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës i Portit Detar Vlorë SHA të marrë masa për të analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për raportimin jo të saktë të treguesve të aktivitetit të shoqërisë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Statusi i pranimit: **Pa pranuar**

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i borderosë së pagave për vitet 2018-2019 u konstatua se paga bazë mbi të cilën llogariteshin sigurimet shoqërore e shëndetësore dhe tatimet nuk përfshinte shtesën për vjetërsinë e punës 1-2% në vit referuar kontratës kolektive të punës dhe niveli të pagave të miratuar në Programin Ekonomik 2018 dhe 2019. Nga zyra e financës nuk është llogaritur dhe nuk është paguar shtesa për vjetërsi në punë konkretisht në vlerën 111,600 lekë në total për vitin 2018 dhe në vlerën 199,440 lekë në total për vitin 2019.

-Në kontratat individuale të punës të hartuara nga zyra e Burimeve Njerëzore nuk specifikohet paga e punonjësve në kundërshtim me Kontratën Kolektive dhe Kodin e Punës. Për sa kohë që përcaktimi i pagës për çdo punonjës bëhet referuar pozicionit të punës, kualifikimit të diplomës dhe vjetërsisë në punë, paga duhet të specifikohet në çdo kontratë individuale dhe jo vetëm në shkresat e emërimit.

-Nga auditimi i strukturës së miratuara si dhe rregullores së miratuar me vendimin Nr. 3 datë 19.03.2019 të Këshillit Mbikëqyrës u konstatua se në disa pozicione të strukturës organizative nuk është përcaktuar niveli dhe lloji i arsimit që kërkohet për pozicionin si dhe në rregullore nuk janë përcaktuar kriteret bazë për çdo pozicion. Nisur nga fakti se pjesë përbërëse e pagës bazë është "paga e grupit" e cila jepet në formë shpërblimi për nivelin e diplomës përcaktimi i kriterëve arsimore dhe profesionale për secilin pozicion përbën domosdoshmëri. Gjithashtu nga auditimi i procedurave: të rekrutimit, lëvizjet paralele dhe ngritja në detyrë të punonjësve u konstatua se, nuk janë parashikuar procedura rekrutimi në rregulloren e shoqërisë si dhe nuk zbatohet asnjë procedurë përzgjedhjeje. Rekrutimi dhe lëvizjet brenda shoqërisë bëhen vetëm me shkresa emërimi nga Administratori i shoqërisë.

5.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Porti Detar SHA Vlorë, Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Zyra e Financës të marrin masa të menjëhershme për përcaktimin e drejtë të elementëve përbërës të pagës dhe pagës bazë mbi të cilën përlllogariten shtesat dhe pakësimet e saj me qëllim trajtimin e drejtë financiar si dhe në të ardhmen të shmangen këto praktika.

5.2 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Porti Detar SHA Vlorë dhe Sektori i Burimeve Njerëzore të marrin masa për plotësimin e kontratave individuale të punës me elementin pagë.

5.3 Rekomandimi: Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës të marrin masa të menjëhershme për përcaktimin në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të shoqërisë Porti Detar SHA Vlorë, të kriterëve të përshtatshme për çdo pozicion pune, si dhe publikimin e vendeve vakante dhe

ndjekjen e procedurave për një proces cilësor dhe të drejtë të rekrutimit dhe zhvillimit profesional të punonjësve.

Menjëherë

Statusi i pranimit: Pranuar

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht dy dosjeve individuale të punës për punësimet e realizuara rishtazi pas dërgimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit, janë zbatuar kërkesat e rekomandimeve nr. 5.1, 5.2 dhe pjesërisht për rekomandimin 5.3 pasi për këtë të fundit nuk rezultoi të jenë marrë masa të menjëhershme për përcaktimin në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të shoqërisë Porti Detar SHA Vlorë, të kriterëve të përshtatshme për çdo pozicion pune por vetëm për publikimin në faqen Web të vendit vakant të pozicionit të punës. Në kushte të tilla rekomandimet 5.1 dhe 5.2 konsiderohen të pranuar dhe të zbatuara plotësisht kurse rekomandimi 5.3 konsiderohet si i pranuar por i zbatuar pjesërisht.

6. Gjetje nga auditimi: Në shkresat e Asamblesë Aksionare për vitet 2017, 2018 dhe 2019 është pasqyruar tabela përmbledhëse e shpenzimeve të miratuara për programin ekonomik përkatës ku përcaktohet numri i punonjësve, paga mesatare dhe fondi i pagave. Nga auditimi u konstatua se në tabelën përmbledhëse të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për Programet Ekonomik të viti 2017 numri total i punonjësve është 120, për vitin 2018 numri total i punonjësve është 121 dhe për vitin 2019 numri total i punonjësve të miratuar është 121. Ndërkohë referuar Programit Ekonomik analitik për të tre vitet nga Shoqëria janë punësuar dhe 15 punonjës “Ngarkim-shkarkimi” si punonjës me kohë të pjesshme duke e çuar numrin e punonjësve në total për vitin 2017 në 135 dhe për vitin 2018 dhe 2019 në 136. Gjithashtu, në tabelën përmbledhëse të miratuar nga Asambleja aksionare në zërin “Fondi i pagave” për vitin 2017, 2018 dhe 2019 përfshihen vetëm shpenzimet “Paga bruto” për punonjësit me kohë të plotë dhe jo për punonjësit me kontratë të cilët referuar kodit të punës duhet të trajtohen njësoj si punonjësit me kohë të plotë dhe shpenzimet për punonjësit me kohë të pjesshme duhet të jenë pjesë e “fondit të pagave” për shoqërinë. Nisur nga sa më sipër konstatohet se MFE dhe Ministria e linjës edhe pse janë shprehur parimisht dakord me përmbajtjen e Programit ekonomik për vitet 2017, 2018 dhe 2019 në tabelat përmbledhëse të miratuara nga Asambleja Aksionare nuk kanë përfshirë punonjësit me kontratë për të cilët shpenzimet e pagave janë respektivisht 3,744,000 lekë për vitin 2018 dhe 4,056,000 lekë për vitin 2019 ose 7,800,000 lekë në total. Nga ana e shoqërisë nuk janë përfshirë në programin ekonomik shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore të punonjësve me kohë të pjesshme për të bërë të mundur trajtimin financiar në përputhje me kontratat përkatëse dhe në respektim të të drejtave të përcaktuara në Kodin e Punës me qëllim shmangien e diskriminimit dhe trajtimin e barabartë të punonjësve.

6.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Portit Detar Vlorë SHA të marrin masa për përfshirjen në planifikim dhe miratim të programit ekonomik-financiar të zërit “fondi i pagave” edhe shpenzimet për punonjësit me kohë të pjesshme, me qëllim trajtimin e plotë financiar të tyre ku të përfshihet jo vetëm paga bruto, por edhe detyrimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore, me qëllim për të dhënë sigurinë e trajtimit të barabartë të punonjësve. Gjithashtu organet drejtuese të shoqërisë në vijimësi të marrin masa për të bërë të mundur përfshirjen e punonjësve me kohë të pjesshme në organikën e shoqërisë dhe trajtimin e tyre si punonjës jo me kohë të pjesshme.

Menjëherë

Statusi i pranimit: Pranuar (pjesërisht)

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht *Listë-pagesës së sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi* rezulton se për punonjësit me kohë të pjesshme janë paguar sigurimet shoqërore dhe shëndetësore por nuk konfirmohet të jenë marrë masa për të bërë të mundur përfshirjen e punonjësve me kohë të pjesshme në organikën e shoqërisë dhe trajtimin e tyre si punonjës me kohë të plotë. Në kushte të tilla ky **rekomandim konsiderohet si i pranuar por i zbatuar pjesërisht**.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për blerjet e vogla për periudhën Nëntor dhe Dhjetor 2017 nga Porti Detar Vlorë sha është konstatuar se: janë kryer gjithsej 20 procedura prokurimi për blerjet me vlera të vogla me vlerë totale të fondit 1,454,688 lekë. Nga këto janë zbatuar 18 procedura me vlerë zbatimi 659,499 lekë. Janë audituar 20 procedura prokurimi për blerjet me vlera të vogla ose 100% e vlerës së tyre.

- Për të gjitha procedurat, përcaktimi i fondit limit është bërë duke u mbështetur në çmimet e tregut, çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga vetë shoqëria, por në asnjë rast nuk janë dokumentuar çmimet e tregut ku është bazuar përlogaritja e vlerës së fondit, si dhe nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si manualet teknike në fuqi, çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, etj).

- Në të gjitha procedurat kërkesat për blerje apo shërbime drejtuar Komisionit për blerjet e vogla, nuk përmbajnë datë apo numër protokolli.

- Për të gjitha procedurat konstatohet se nuk është e nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit me vlera të vogla.

- Për procedurën e prokurimit “Drekë me rastin e Vitit të Ri” me fond limit 200,000 lekë, nuk ka asnjë dokument që të vërtetojë kryerjen e shërbimit dhe marrjen në dorëzim të tij në përputhje me kushtet e kontratës, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, pika 61, duke rezultuar në shpenzim të paligjshëm në vlerën 159,000 lekë me TVSh.

- Për procedurën “Blerje material për shërbim të brendshëm” me fond limit 29,750 lekë, nga krahasimi i datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit, 13.12.2017 dhe datës së fletës së hyrjes në magazinë 12.12.2017 konstatohet se malli është bërë hyrje në magazinë përpara se procedura të zhvillohet. Për sa më sipër procedura paraqitet fiktive me fitues të paracaktuar.

- Me urdhrin e prokurimit nr. 135, datë 01.12.2017 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor është urdhëruar komisioni i prokurimit për blerjet e vogla i cili ka filluar procedurën e prokurimit “Blerje tub autozjarrfikëse” me fond limit 29,166.7 lekë. Urdhri i prokurimit është shoqëruar nga proces verbali i rasteve të emergjencës konform formularit 4, datë 01.12.2017, në kushtet e përmbytjes së hyrjes së godinës së Administratës së Portit Detar Vlorë SHA pas reshjeve të shumta të shiut. Nga auditimi është konstatuar se për të njëjtin qëllim është zhvilluar një procedurë e mëparshme prokurimi me vlerë të vogël me urdhër prokurimi nr. 126, datë 08.11.2017 për procedurën “Blerje tubo thithje dhe shkarkim uji Ø50, plastike (3+150) ml dhe fasheta uji 3 copë” me fond limit 16,791.67 lekë. Fakti që në më pak se një muaj është zhvilluar një procedurë prokurimi për të njëjtin qëllim dëshmon për mungesën e efektivitetit të përdorimit të fondit të procedurës së parë prej 16,791.67 lekë. Veprime e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20/11/2006 “*Për prokurimin publik*”, të ndryshuar, neni 1, VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, neni 59, pika 2 si dhe nenin 64 pika 2 si dhe në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.11.2011, “*Për*

menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pika 36 dhe 61 "*Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve*", Udhëzimin Nr. 3, datë 27.01.2015 "*Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël*" i ndryshuar dhe Udhëzimin Nr. 2, datë 24.04.2017, pika 6.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit lidhur me procedurat e prokurimit me vlerë të vogël për vitin 2018 rezulton se janë realizuar 18 procedura, me fond limit në shumën totale 2,771,932 lekë pa TVSh dhe në vlerë kontrate në shumën totale 2,067,444 lekë pa TVSh janë audituar në masën 100% të tyre, për vitin 2019 rezulton se janë realizuar 16 procedura, me fond limit në shumën totale 3,831,800 lekë pa TVSh dhe në vlerë kontrate në shumën totale 2,875,768 lekë pa TVSh janë audituar në masën 100% të tyre:

- Për 1 procedurë "Blerje pajisje zyre" rezulton se komisioni më datë 04.07.2019 ka shpallur fitues OE "*SHAGA*", i cili ka lëshuar faturën tatimore nr. 6747/2, datë 10.07.2019 në shumën 623,800 lekë, deri më datë 31.12.2019 nuk është kryer likuidimi, jo sipas kushteve të përcaktuara në kontratën lidhur midis dy palëve me shkresën nr. 266 prot., datë 05.07.2019.

- Për 2 procedura me vlerë kontrate në shumën 322,800 lekë me TVSh, rezulton se u është dërguar ftesë-oferta operatorëve ekonomikë, natyra i aktivitetit të të cilëve nuk përputhet me atë të objektit të prokurimit;

- Për 2 procedura me vlerë kontrate në shumën 773,800 lekë me TVSh, rezulton se njoftimi i shpalljes fitues të operatorit ekonomik, është kryer duke mos respektuar afatin e njoftimit të operatorëve sipas radhës dhe afatit kohor;

- Për 3 procedura me vlerë kontrate në shumën 351,200 lekë me TVSh, rezulton se nuk është dërguar ftesë për ofertë 5 operatorëve ekonomik;

- Për 1 procedurë me vlerë kontrate në shumën 50,000 lekë me TVSh, rezulton se është realizuar si blerje emergjente duke shmangur procedurat normale të prokurimit me vlera të vogla;

- Për 2 procedura me vlerë kontrate në shumën 796,600 lekë me TVSh, rezulton se në ftesën për ofertë drejtuar ekonomik, specifikimet teknike nuk janë përcaktuar për të gjithë mallrat për të cilat kryhet shpenzimi;

- Për të gjitha procedurat e prokurimit me vlerë të vogël për vitin 2019, marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara është kryer vetëm nga një grup i cili është i ngritur në fillim viti por konstatohet se anëtarët e grupit nuk janë specialist fushe për të gjitha mallrat të cilat janë marrë në dorëzim për procedurat e kryera;

- Për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël për vitin 2019 rezulton se në kërkesat për mallra nuk argumentohet sasia e tyre por evidentohet vetëm lista ose preventivi; Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit elektronik*" i ndryshuar, Neni 40 pika 5, Udhëzimi nr. 3, datë 08.01.2018 "*Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*", i ndryshuar, pika 6, pika 7 germa b, Pika 15 si dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.11.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar, Pika 42, pika 43.

7.1 Rekomandimi: Komisioni për Blerjet e Vogla të Portit detar Vlorë SHA të marrë masa për të dokumentuar përllogaritjen e vlerës së fondit, si dhe për të argumentuar alternativën e zgjedhur për përcaktimin e tij, të marrë masa për nënshkrimin e deklaratave të konfliktit të interesit. Në rastin e procedurave të shërbimeve të marrë masa për miratimin dhe likuidimin e tyre vetëm bazuar në dokumentacion vërtetues që dokumenton kryerjen e shërbimit.

7.2 Rekomandimi: Porti Detar Vlorë, Zyra e Administrimit Financiar, Zyra Juridike të marrë masa që:

- Të kryhen likuidimet brenda afateve të përcaktuara në kontrata duke shmangur penaltetet;

- Komisionet për marrjen në dorëzim të punimeve/mallrave e shërbimeve, të përbëhen nga specialist sipas fushave përkatëse;
- Në ftesat për ofertë drejtuar operatorëve ekonomik të përcaktohen për të gjithë artikujt/mallrat specifikimet teknike.

Në vazhdimësi

Statusi i pranimit: Pranuar (pjesërisht)

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht një procedure me objekt “*Projektor LED SMD 200 W, Copë 10*” rezulton se janë realizuar kërkesat e parashtruara në rekomandimet nr. 7.1 dhe nr. 7.2. Në vijim zbatimi i këtyre rekomandimeve ngelet për tu verifikuar nga grupet e auditimit të KLSH-së. Në kushte të tilla këto rekomandime **konsiderohen të pranuar dhe të zbatuara plotësisht.**

8. Gjetje nga auditimi: Bashkëngjitur veprimeve të kryera me bankë, mungonte dokumentacioni autorizues i shpenzimit, si urdhra blerje, kontrata, etj., si dhe dokumentacioni vërtetues i shpenzimit të kryer, ku pjesa më e madhe e dokumentacionit rezultonte të ishte fotokopje, si dhe nuk ishte i plotë për sa i përket mungesës në disa raste të fletëhyrjeve, situacioneve, aktmarrjeve në dorëzim etj. Konkretisht, për vitin 2018 kanë rezultuar dy raste: Likuidimin e OE “*IMES-D*” me vlerë 504,000 lekë dhe përmbaruesin “*Zig E. Zanaj*” me vlerë 15,166 lekë si dhe për vitin 2019 kanë rezultuar katër raste likuidimi për OE “*Enton Cela*” me vlerë 14,900 lekë, OE “*A.T and Tours*” me vlerë 40,504 lekë, OE “*Diftir Tahiraj*” 78,000 lekë dhe OE “*SHAGA*” me vlerë 623,800 lekë, ku përveç faturës tatimore nuk kishte asnjë dokumentacion justifikues bashkëlidhur urdhërtransferts. Megjithatë, parregullsitë e mësipërme kanë të bëjnë me keq organizimin e mbajtjes së dokumentacionit të veprimeve me bankë, pasi për rastet e sipër përmendura u kërkua dokumentacioni origjinal i transaksioneve të kryera dhe na u vu në dispozicion.

8.1 Rekomandimi: Shefi i Zyrës së Financës të marrë masa të menjëhershme, për dokumentimin e veprimeve të kryera me bankë në dy aspekte, konkretisht: dokumentacionin autorizues dhe dokumentacionin justifikues të shpenzimeve, duke bashkëngjitur dokumentacionit origjinal për çdo transaksion të kryer.

Menjëherë

Statusi i pranimit: Pa pranuar

9. Gjetje nga auditimi: Në raportin e auditimit për vitin 2018, audituesit e pasqyrave financiare kanë dhënë Opinion me rezervë. Por nga auditimi i këtij raporti dhe letrës drejtuar drejtimin të shoqërisë, konstatohet se opinionin e auditimit në pasqyrat financiare, nuk është pasqyruar qartë dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) 250 “Mbajtja Parasysh e Ligjeve dhe Rregullave në një Auditim të Pasqyrave Financiare”. Kjo konstatohet dhe nga fakti se ky raport është ridorëzuar për herë të dytë pasi, Asambleja Aksionare ka konstatuar problematika në raportin e auditimit, duke kërkuar riformulimin e opinionit të audituesve të pavarur.

Në pasqyrat e vitit 2018, zëri Mallra për rishitje paraqiten në vlerën 8,264,765. Kjo gjendje vazhdon që prej vitit 2017 e pandryshuar edhe pse gjatë vitit 2017 kanë dal materiale jashtë përdorimit në vlerën 65,702 lekë, nuk janë pasqyruar në kontabilitet si shitje në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Standardet kombëtare të kontabilitetit.

9.1 Rekomandime: Nga Asambleja Aksionare dhe Këshilli Mbikëqyrës të merren masat që auditimi i pasqyrave financiare të kryhet në përputhje të plotë me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, me qëllim marrjen e sigurisë për përmbajtjen e pasqyrave financiare.

9.2 Rekomandimi: Përgjegjësi i Zyrës së Financës të marrë masa për llogaritjen dhe pasqyrimin e ndryshimeve në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare pas daljes jashtë përdorimit të zërit Mallra për rishitje.

Në vazhdimësi

9.1 Statusi i pranimi: Pranuar (pjesërisht)

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht materialeve sqaruese të dorëzuara nga ana e Përgjegjësit të Zyrës së Financës Pasqyrat Financiare për vitin 2019, rezulton se janë marrë masat për auditimin e pasqyrave financiare në përputhje të plotë me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Në kushte të tilla rekomandimi 9.1 konsiderohet si i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.

9.2 Statusi i pranimi: Pranuar (pjesërisht)

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim nuk është zbatuar. Në kushte të tilla rekomandim 9.2 konsiderohet si i pranuar por i pa zbatuar.

10. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat e pozicionit financiar 2018, pasivi, në zërin e kapitaleve dhe rezervave nuk është pasqyruar rezerva e rivlerësimit (e cila duhet të jetë reflektuar në aktiv me rritjen e vlerës së AAM dhe në pasiv në zërin Kapitale dhe rezerva), saktësisht në zërin rezerva e rivlerësimit referuar SKK 2 bazohet në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 1 SNK 1, “Paraqitja e pasqyrave financiare” SNK 7, “Pasqyrat e fluksit të parasë” dhe SNK 24 “Shpjegimet mbi palët e lidhura”. Rezerva e rivlerësimit duhet të mbahet analitike për çdo aset dhe jo në total. Konkretisht vlera 21,253,707 lekë diferencë duhet të ishte pasqyruar në zërin 10.3 rezerva e rivlerësimit. Shoqëria referuar Raportit të rivlerësimit të aseteve për pakësimin e AAM në shumën 15,094,805 lekë duhet ta kishte trajtuar si shpenzim të pa zbritshëm për efekt të llogaritjes së tatimit të fitimit. Sa më sipër tregon një paraqitje jo të drejtë të zërave të klasës së kapitalit sepse nuk është paraqitur vlera e vlerësimit në zë më vete por ky klasifikim nuk ka ndikim në vlerë në PF.

10.1 Rekomandimi: Përgjegjësi i Zyrës së Financës të marrë masa për evidentimin dhe pasqyrimin e rezervave të rivlerësimit në pasqyrën e pozicionit financiar te vitit pasardhës.

Menjëherë

Statusi i pranimi: Pa pranuar

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të pasqyrave financiare për vitet 2017 dhe 2018, konstatohet se, shënimet shpjeguese që shoqërojnë pasqyrat financiare paraqiten thjeshtë, me informacion të përgjithshëm dhe mungojnë sqarime të nevojshme për ecurinë e zërave të pasqyrave financiare. Shënimet shpjeguese në pasqyrat financiare janë element i rëndësishëm, të cilat duhet ndër të tjera të sigurojnë edhe atë informacion shtesë, që nuk mund të paraqitet në të gjitha formatet e pasqyrave financiare referuar Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, SKK 1 “Kuadri i Përgjithshëm për Përgatitjen e Pasqyrave Financiare”, pika 67, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, kreu III, pika 25, Aneksi 2.

11.1 Rekomandimi: Nga drejtoria e shoqërisë Porti Detar SHA Vlorë dhe Zyra e Administrimit Financiar, të marrin masat që gjatë hartimit të pasqyrave financiare, ato të përfshijnë të gjitha

formatet e tyre sipas përcaktimeve ligjore, duke siguruar të dhëna dhe informacione të plota shpjeguese për përdoruesit e tyre.

Në vazhdimësi

Statusi i pranimit: Pranuar

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht materialeve sqaruese të dorëzuara nga ana e Përgjegjësit të Zyrës së Financës Pasqyrat Financiare për vitin 2019, rezulton se janë marrë masat për përfshirjen e informacioneve shpjeguese. Në kushte të tilla **rekomandimi konsiderohet si i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.**

12. Gjetje nga auditimi: Administratori dhe sektori i financës në përgatitjen e pasqyrave financiare, kanë përdorur norma për llogaritjen e shpenzimeve të amortizimit të aktiveve afatgjata materiale, specifike të veprimtarisë portuale, të pa vlerësuara dhe aprovuara nga Këshilli Mbikëqyrës, në kundërshtim me Ligjin Nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” Neni 5, 9, “Mbajtja e kontabilitetit”, ku citohet se “Të gjitha njësitë ekonomike e organizojnë mbajtjen e kontabilitetit mbi bazën e parimeve dhe të metodave, që përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit; “Respektimi i standardeve kontabël”, 1. Pasqyrat financiare paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri gjendjen financiare, performancën, ndryshimet në gjendjen financiare dhe rrjedhjen e parasë së njësisë ekonomike. Pasqyrat financiare përgatiten dhe paraqiten në përputhje me standardet kontabël” dhe Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 1, pika 103, ku citohet se: Disa të dhëna financiare, të paraqitura në pasqyrat financiare, bazohen në vlerësime të bëra nga drejtuesit e njësisë ekonomike,...” dhe Standardi Kombëtar i Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale”, pika 39 citon se “Çdo njësi ekonomike cakton metodat e amortizimit dhe normat e amortizimit në politikat dhe procedurat e saj kontabël, të cilat duhet të përdoren për amortizimin e aktiveve afatgjata materiale”.

12.1 Rekomandimi: Nga Drejtimi i shoqërisë të merren masa për aprovimin e normave, të mbështetura këto në studime dhe vlerësime për jetëgjatësinë e aktiveve afatgjata materiale, nga specialistët e fushës dhe brenda limiteve ligjore.

Menjëherë

Statusi i pranimit: Pranuar

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht materialeve sqaruese të dorëzuara nga ana e Përgjegjësit të Zyrës së Financës Pasqyrat Financiare për vitin 2019, rezulton se janë marrë masat për ndryshimin e normave të amortizimit por nuk konfirmohet se janë aprovuar ato paraprakisht nga drejtimi i shoqërisë. Në kushte të tilla **rekomandimi konsiderohet si i pranuar por i zbatuar pjesërisht.**

13. Gjetje nga auditimi: Lidhur me ekzistencën dhe lëvizjen e aktiveve të qëndrueshme kemi konstatuar se për vitet 2017 dhe 2018 Shoqëria nuk ka hartuar regjistër kontabël të përditësuar të aktiveve që zotëron apo që ka në administrim, i cili në varësi të llojit të përmbajtjes kërkesat minimale si datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Për vitin 2019 regjistri kontabël nuk është mbajtur sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Sa

më sipër është në kundërshtim me Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, Pikat 26 deri në 33.

13.1 Rekomandimi: Porti Detar Vlorë, të marrë masa nëpërmjet strukturave përgjegjëse të Shoqërisë, për të bërë të mundur sa më parë hartimin e regjistrave kontabël të aktiveve, të cilat të jenë sipas formateve të kërkuara dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në vazhdimësi

Statusi i pranimit: Pranuar

Në lidhje me këtë rekomandim nuk u vu në dispozicion asnjë dokument. Në kushte të tilla ky rekomandim **konsiderohet i pranuar por i pa zbatuar.**

14. Gjetje nga auditimi: Gjatë zhvillimit të procesit të inventarizimit për vitin 2017, në komisionin e ngritur nga administratori i Shoqërisë në cilësinë e nëpunësit autorizues, janë caktuar persona të cilët kanë aktive materiale në ngarkim/përdorim dhe kanë nënshkruar në procesin e kryerjes së inventarizimit, në kushtet e konfliktit të interesit. Në përbërje të komisionit për vlerësimin e aktiveve për periudhën objekt auditimi nuk është caktuar nëpunësi zbatues si kryetar i komisionit si dhe nuk është përcaktuar gjendja e aktiveve dhe lista e atyre që do të vlerësohen.

- Përgjatë periudhës objekt auditimi ka ndryshuar stafi i Magazinës. Me urdhër të administratorit të Shoqërisë nr. 163, datë 10.06.2019 është ngritur komisioni për inventarizimin e gjendjes së mallrave në magazinë. Me urdhrat respektiv nr. 169, datë 01.07.2019 dhe nr. 170, datë 02.07.2019 është kryer zëvendësimi i punonjësit të magazinës. Nga komisioni i përmendur më sipër është mbajtur relacion me shkresën nr. 259, datë 28.06.2019 për listën e artikujve të magazinës printuar nga programi “Financë 5” më datë 05.07.2019. Relacioni është nënshkruar nga komisioni si dhe nga të dy punonjësit që shkëmbejnë pozicionin e magazinierit. Në kushte të tilla relacioni është mbajtur në mënyrë formale ku punonjësi zëvendësues ka nënshkruar në relacion pa u emëruar në këtë pozicion. Nga auditimi rezulton se ndërrimi i punonjësit të magazinës është kryer pa inventarin përkatës.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit lidhur me aktivet e nxjerra jashtë përdorimit dhe asgjësimit të tyre për vitin 2017 rezulton se, në përbërje të relacionit mbajtur nga komisioni i inventarizimit janë vlerësuar aktive për t'u nxjerrë jashtë përdorimit me vlerë 65,702 lekë, të cilat duhen të dalin nga regjistri i aktiveve të shoqërisë. Në listën e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit ka materiale të cilat konsiderohen të dëmshme, për të cilat hedhja apo asgjësimi i tyre, duhet të kryhet me një procedurë të mirëfilltë për shkak të natyrës dhe përbërjes së tyre me qëllim parandalimin dhe pakësimin e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike të destinuara për asgjësim si dhe të përmirësimit të performancës mjedisore. Nga administratori i Shoqërisë nuk janë përcaktuar rregulla për mënyrën e transportit, asgjësimit të tyre dhe nuk disponohet asnjë korrespondencë me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për lejimin e asgjësimit dhe gruposjes së pajisjeve të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe impaktin që kanë në komunitet. Këto pajisje janë IT dhe elektronike si më poshtë: Printer Samsung M1 1665 copë 1, makinë llogaritëse copë 1, RAM DDR 1 512 MB copë 2, USB copë 2, DDR21 GB copë 1, Avometër dixhital copë 1, Indikator copë 1, Nivel cilësor copë 1, Kabëll Lan copë 50. Komisioni për tjetërsim dhe asgjësim, me shkresën nr. 183 prot., datë 12.03.2018 ka mbajtur procesverbalin lidhur me kryerjen e asgjësimit të aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit, por në të citohet se: *“Të gjitha materialet që dalin jashtë përdorimit u hodhën në vend grumbullimin e mbeturinave”*. Nga sa më sipër konstatohet se nuk vërtetohet dhe justifikohet me dokumentacion, mënyra e asgjësimit, transportit si dhe vendi në të cilën është kryer asgjësimi i aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit.

Sa më sipër është në kundërshtim me Ligji nr. 10431, "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar, Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" i ndryshuar, Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit" i ndryshuar, Kreu I pika 1 pika 2, VKM nr. 957, datë 19.12.2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike", Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 10, pika 13, pika 81, pika 82, pika 85 germa c, pika 99, pika 100, pika 102 dhe pika 122.

14.1 Rekomandimi: Drejtoria e Portit Detar Vlorë, të marrë masat e duhura që në proceset e vlerësimit të aktiveve dhe inventarizimit të shoqërisë, të caktohet nëpunësi zbatues i kryetar i komisionit si dhe në përbërje të komisioneve mos të jenë emëruar persona të cilët kanë aktive në ngarkim/përdorim.

14.2 Rekomandimi: Drejtoria e Portit Detar Vlorë, të marrë masa ku të përcaktohen rregulla të qarta procedurale të lënies dhe marrjes së detyrës sidomos në rastet kur ka vlera materiale në ngarkim si dhe të eliminohen procedurat formale në dorëzimin dhe marrjen e detyrave.

14.3 Rekomandimi: Drejtoria e Portit Detar Vlorë, Zyra e Administrimit Financiar, të marrin masa në të ardhmen që në lidhje me procesin e asgjësimit të aktiveve të mbahet parasysh kuadri rregullator ligjor për mbrojtjen e mjedisit. Gjithashtu, të kërkohet plotësimi i saktë i dokumentacionit të rregullt dhe justifikues sipas përcaktimeve ligjore.

Në vijimësi

Statusi i pranimi: Pranuar

14.1 Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht sipas shkresës me nr. 456 prot., datë 01.12.2020 Urdhër nr. 228 datë 01.12.2020 "Mbi komisionet e inventarizimit" janë ngritur këto komisione me përbërje të tilla me qëllim shmangien e konfliktit të interesit. Në vijim zbatimi i këtij rekomandimi ngelet për tu verifikuar nga grupet e auditimit të KLSH-së. Në kushte të tilla ky rekomandim **konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.**

14.2 Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht gjatë dorëzimit të materialeve në ngarkim të ish – punonjësit të IT z. Ermal Hoxha në ngarkim të znj. Klaudia Çuni, sipas shkresës me nr. 355/2 prot., datë 24.11.2020 janë respektuar kërkesat përkatëse për kalimin e këtyre aktiveve. Në vijim zbatimi i këtij rekomandimi ngelet për tu verifikuar nga grupet e auditimit të KLSH-së. Në kushte të tilla ky rekomandim **konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.**

14.3 Sipas dokumentacionit rezulton se nuk janë kryer më asgjësime. Në vijim zbatimi i këtij rekomandimi ngelet për tu verifikuar nga grupet e auditimit të KLSH-së. Në kushte të tilla ky rekomandim **konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.**

15. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se për periudhën objekt auditimi janë realizuar në total dhe audituar në masën 100 % të tyre procedura si më poshtë:

2018

- 1 procedurë prokurimi e llojit *Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës* me vlerë të fondit limit 19,627,350 lekë pa TVSh për të cilën është lidhur kontrata me vlerë 19,627,350 lekë pa TVSh;

2019

- 1 procedurë prokurimi e llojit *Kërkesë për Propozime* me vlerë të fondit limit 2,213,314 lekë pa TVSh për të cilën është lidhur kontrata me vlerë 2,213,314 lekë pa TVSh;

- 1 procedurë prokurimi e llojit *Shërbim Konsulence* me vlerë të fondit limit 10,167,010 lekë pa TVSh për të cilën është lidhur kontrata me vlerë 9,600,000 lekë pa TVSh;

Nga këto, në 2 procedura prokurimi, konkretisht në vitin 2018 "*Kryerja e punimeve shtesë të paparashikuara në objektin 'Zgjerimi i terminalit të Pasagjerëve'*" dhe në vitin 2019 "*Blerje Karburanti*" në DST janë vendosur kritere të paargumentuara dhe/apo jo në përputhje me objektin e prokurimit. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, neni 1 "*Objekti dhe qëllimi*" pika 2, germa (a), (b), (c), (ç), (d) dhe (dh), neni 20, neni 46, neni 48, pika 4, paragrafi i dytë, neni 51, pika 1, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", ndryshuar, Kreu I, neni 11, pika 3, germa b, neni 26, pika 3, pika 5, Kreu II, Seksioni 2, neni 27, pika 2, neni 58, paragrafi i fundit, neni 61, pika 2 si dhe VKM nr. 410 datë 13.05.2015 "*Për Krijimin, Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial*", Kreu I Krijimi i Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial, pika 1.

15.1 Rekomandimi: Komisionet e ngritura për hartimin e Kritereve të Përgjithshme/Veçanta të marrin masat e duhura për të vendosur si kushte për kualifikim vetëm kritere të domosdoshme dhe të lidhura drejtpërdrejtë me Investimin / mallin / shërbimin.

Në vazhdimësi

Statusi i pranimit: Pa pranuar

16. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se në dy raste, konkretisht në procedurat e prokurimit me objekt "*Kryerja e punimeve shtesë të paparashikuara në objektin 'Zgjerimi i terminalit të Pasagjerëve'*", "*Blerje Karburanti, viti 2019*", nga ana e Titullarit, pas anulimit të procedurave dhe nisjen e procedurave të reja, nuk janë emëruar me urdhër të ri anëtarët e NJP dhe KVO por është vijuar me Urdhrat dhe emërimet e mëparshme. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", ndryshuar, neni 56, paragrafi i parë si dhe nenin 57 pika 2.

16.1 Rekomandimi: Porti Detar Vlorë SHA duhet të marrë masa për emërimin e anëtarëve të komisioneve të ngritura për procedurat e prokurimeve publike, nëpërmjet Urdhrave të rinj, në rastet e anulimit të procedurave të mëparshme me qëllim një ndarje të qartë të përgjegjësisë.

Në vazhdimësi

Statusi i pranimit: Pranuar

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton se nuk ka pasur procedura të reja prokurimi. Në vijim zbatimi i këtyre rekomandimeve ngelet për tu verifikuar nga grupet e auditimit të KLSH-së. Në kushte të tilla ky rekomandim **konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.**

17. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se për periudhën 01.11.2017 deri më 31.12.2019, në 2 raste, përkatësisht në procedurat:

- "*Kryerja e punimeve shtesë të paparashikuara në objektin 'Zgjerimi i terminalit të Pasagjerëve'*", viti 2018 me vlerë të fondit limit 19,627,350 lekë pa TVSh dhe vlerë të kontratës 19,627,350 lekë pa TVSh me OE "*JUNIK*" ShPK të shpallur fitues;

- "*Blerje Karburanti*", viti 2019 me vlerë të fondit limit 2,213,314 lekë pa TVSh dhe vlerë të kontratës 2,213,314 lekë pa TVSh me BOE "*KASTRATI*" SHA & KASTRATI ShPK të shpallur fitues;

nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave janë kualifikuar OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e veçanta të kualifikimit. Në këto 2 raste, procedurat e prokurimit duhet të ishin anuluar dhe të rinisnin një të re. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, germa (a), (b), (c), (ç), (d) dhe (dh), neni 20, neni 46, neni 53, pika 3 dhe 5, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 66, VIII, 74 Bashkimi i operatorëve ekonomikë, pika 3 si dhe VKM nr. 410 datë 13.05.2015 “Për Krijimin, Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”, Kreu I Krijimi I Inspektoratit Shtetëror Teknik Dhe Industrial, pika 1.

17.1 Rekomandimi: Porti Detar Vlorë SHA dhe komisionet e ngritura për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave/ankesave të marrin masa për vlerësimin me përgjegjësi dhe profesionalizëm të dokumentacionit të ofertuesve me qëllim rritjen e efektivitetit të procedurave të prokurimit, krijimin e kushteve të përshtatshme për rritjen e konkurrencës mes operatorëve ekonomikë si dhe rritjen e besueshmërisë ndaj Shoqërisë.

Në vazhdimësi

Statusi i pranimit: **Pa pranuar**

18. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se pas përfundimit të procedurës së prokurimit dhe lidhjes së kontratës së prokurimit me objekt “Blerje Karburanti”, viti 2019 me vlerë të fondit limit 2,213,314 lekë pa TVSh dhe vlerë të kontratës 2,213,314 lekë pa TVSh, nga ana e komisionit të marrjes në dorëzim të karburantit, rezultoi se ky produkt nuk plotëson plotësisht specifikimet teknike të përcaktuara nga komisioni i ngritur me Urdhër nr. 52 datë 22.02.2019 për hartimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike. Konkretisht, nuk dëshmohej përmbushja e kriterit në lidhje me cilësinë e karburantit “Pika e bllokimit të filtrit CFFP ¼ - 31/10 1/11 – 31/3 sipas standardit EN 116:1997, kjo pasi fleta e analizave nuk e pasqyron të kryer këtë lloj analize. Njëkohësisht nuk rezultoi se kryer as analiza në lidhje me distilatin që vlon deri në 150 ° C. Për sa më sipër rezultoi se vlera prej **1,307,075 lekë me TVSh** e likuiduar deri në fund të periudhës objekt auditimit është kryer për produkte që nuk dëshmojnë se përmbushen kërkesat e Autoritetit Kontraktor për këtë produkt. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 77, pika , Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, neni 45 si dhe Urdhri nr. 160 datë 10.06.2019.

18.1 Rekomandimi: Porti Detar Vlorë SHA duhet të marrë masa për të rritur efektivitetin e punës së komisioneve të marrjes në dorëzim të mallrave duke shmangur kështu mos përmbushjen në masën 100 % të kriterëve të vendosura për mallra.

Në vijimësi

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se nuk janë kryer procedura të reja prokurimi. Në vijim, zbatimi i këtij rekomandimi ngelet për tu verifikuar nga grupet e auditimit të KLSH-së. Në kushte të tilla **ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.**

19. Gjetje nga auditimi: Procedura e prokurimit me objekt Hartimi i projekt-preventivit të zbatimit për tenderin “Rikonstruktion i kalatës lindore në Portin Detar Vlorë”, me vlerë kontrate 11,520,000 lekë me TVSH, nuk është hartuar konform rregullores për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, VKM nr. 408 datë 13.05.2013 e ndryshuar, pasi në pikën 9 të kërkesave të

përgjithshme përcakton realizimin e dokumenteve deri në marrjen e lejes së zhvillimit të projektit, ndërkohë që ligjërisht kërkohet që projekti të pajiset me leje ndërtimi për tu realizuar. Në detyrë nuk janë kërkuar specifikisht projektet me relacionet përkatëse, deklaratat e përgjegjësive profesionale të projektuesve, policat e sigurimit të projektuesve të gjitha këto të nënshkruara elektronikisht, si kusht themelor për aplikimin në sistemin elektronik të lejeve, e cila është baza e të dhënave shtetërore për të gjitha kërkesat dhe lejet, sipas legjislacionit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, dhe realizon ndërveprimin e të gjitha subjekteve të përfshira në proces, duke përfshirë aplikuesin, autoritetet përgjegjëse për dhënien e lejeve dhe institucionet publike që kanë detyrimin ligjor të japin informacion apo pëlqim lidhur me kërkesën për leje. Në kundërshtim me VKM nr. 354, datë 11.05.2016, *"Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim"*, neni 3 pika 5, nuk janë përcaktuar në Dokumentet Standarde të Tenderit (DST) kriteret për tipologjinë e shërbimit të ndarë sipas fazave: Analiza e detyrës së projektimit /termat e referencës dhe përcaktimi i bazës së projektit; Projekt-ideja paraprake; Projekt-ideja përfundimtare; Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit; Projekti i zbatimit; Preventivi përfundimtar; Përgatitja e dokumentacionin për procedurë tenderimi. Rrjedhimisht edhe mënyra e pagesës e përcaktuar në kontratë nuk parashikon tolerancat e nevojshme për koston e llogaritshme të tenderuar dhe koston e llogaritshme përfundimtare. Sipas proces verbalit nr. 155/3 datë 13.05.2019 është bërë hapja e procedurës së dorëzimit të ofertave të tenderit, në prezencë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe Njësisë së Prokurimit, ku pas verifikimit në sistem rezultuan gjithsej 6 operatorë ekonomik pjesëmarrës. Me anë të Proces Verbalit nr. 155/7 prot., datë 23.05.2019 KVO ka bërë shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit dhe të ofertave të paraqitura nga 6 operatorët ekonomik pjesëmarrës ku ka rezultuar se katër prej operatorëve nuk plotësonin kriteret, kryesisht kriterin e kapacitetit teknik përvojë e ngjashme. Nga auditimi i procedurës së prokurimit ka rezultuar se as fituesi operatori ekonomik *"C.E.C GROUP"* ShPK nuk plotëson kriterin e eksperiencës së ngjashme pasi nuk ka të vërtetuara shërbime konsulence për punime detare si dhe nuk plotëson kushtin që të ketë të punësuar dhe të figurojnë në listë-pagesa specialistët: inxhinier ndërtimi, inxhinier hidroteknik, inxhinier elektrik, specialist mjedisi dhe inxhinier topograf. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 *"Për prokurimin publik"* të ndryshuar; VKM nr. 354, datë 11.05.2016, *"Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim"* dhe VKM nr. 408 datë 13.05.2013 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, e ndryshuar.

19.1 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Porti Detar Vlorë SHA të marrë masa që për të gjitha procedurat shërbim konsulence të hartojë detyra projektimi ku të përfshihen të gjithë komponentët e nevojshëm teknik, ligjor dhe financiar për garantimin e realizimit të shërbimit, si dhe vendosjes së kriterëve që garantojnë aftësinë zbatuese të operatorëve.

19.2 Rekomandimi: Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të Portit Detar Vlorë SHA të marrë masa për vlerësimin dhe trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve të ofertuesve në mënyrë të barabartë duke argumentuar për secilin rast arsyet specifike të plotësimit apo mosplotësimit të kriterëve nga ana e ofertuesve.

Në vazhdimësi

Statusi i pranimit: Pranuar

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton se nuk janë kryer procedura të reja prokurimi. Në vijim, zbatimi i këtij rekomandimi ngelet për tu verifikuar nga grupet e auditimit të KLSH-së. Në kushte të tilla këto rekomandime konsiderohen të pranuar dhe të zbatuara plotësisht.

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 292/7 prot datë 20.08.2019 për Hartimin e projekt-preventivit të “Rikonstruksion i kalatës lindore në Portin Detar Vlorë” me operatorin fitues “C.E.C Group” me vlerë 9,600,000 lekë pa TVSh dhe afat realizimi 1 muaj, rezultoi se për rrjedhojë të mangësive të konstatuara në hartimin e detyrës së projektimit, shërbimi i realizuar nga konsulenti nuk siguron dokumentacionin e nevojshëm për aplikimin dhe pajisen me leje ndërtimi, miratimi i të cilës në këtë rast është kompetencë e KKT-së. Në kundërshtim me detyrat e përcaktuara për tu zbatuar nga konsulenti në specifikimet e kontratës, nga ana e konsulentit nuk janë dorëzuar projektet e plota pasi mungojnë të gjitha materialet në format DËG, mungon projekti i sistemit të furnizimit me ujë me energji elektrike dhe projekti i mbrojtjes nga zjarri. Për sa më sipër komisioni i marrjes në dorëzim të projektit ka marrë në dorëzim një shërbim të paplotë dhe në kundërshtim me kontratën. Nga auditimi i projektit dhe preventivit të realizuar rezulton se vlera totale e preventivit të punimeve është 483,824,045 lekë me tvsh, e cila më shumë se dy fishi i vlerës së llogaritur të ndërtimit të objektit në vlerën 201,999,600 lekë me TVSH, akorduar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, për realizimin e punimeve. Në këto kushte rezulton se duke qenë se në kontratën e shërbimit nuk është parashikuar që vlera e preventivit të projektit ti përmbahet vlerës së fondit të akorduar për realizimin e punimeve, Porti Detar Vlorë SHA nuk ka fond të mjaftueshëm për realizimin e punimeve të rikonstruksionit të kalatës lindore. Sa më sipër bie ndesh me parimet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efencës të shprehura në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, neni 5, si dhe Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.11.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

20.1 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Porti Detar Vlorë SHA të marrë masa që për të gjitha procedurat shërbim konsulence të hartojë kontrata ku të përfshihen të gjithë komponentët e nevojshëm teknik, ligjor dhe financiar që garantojnë realizimin e zbatimit të punimeve.

Në vazhdimësi

20.2 Rekomandimi: Komisioni i marrjes në dorëzim të shërbimeve të konsulencës të marrë masa për verifikimin e shërbimit sipas kushteve të përcaktuara në kontratë dhe marrjen në dorëzim të tij në përputhje me komponentët që garantojnë dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e miratimeve e lejeve përkatëse për zbatimin e punimeve të ndërtimit.

Në vazhdimësi

Statusi i pranimi: Pranuar (pjesërisht)

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton se nuk janë kryer procedura të reja prokurimi. Në vijim, zbatimi i këtij rekomandimi ngelet për tu verifikuar nga grupet e auditimit të KLSH-së. Në kushte të tilla **këto rekomandime konsiderohen të pranura dhe të zbatuara plotësisht.**

21. Gjetje nga auditimi: Nga shoqëria Porti Detar Vlorë nuk është zbatuar Ligji për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin si dhe nuk është implementuar në Rregulloren e Brendshme të saj. Ligji nuk njihet nga strukturat drejtuese të shoqërisë e punonjësit e saj dhe për pasojë nuk ka funksionuar në asnjë hallkë të njësisë ku drejtuesit nuk kanë bërë një vlerësim të efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

- Për periudhën nga data 06.09.2017 deri më 13.12.2018 Administratori në cilësinë e Titullarit të Shoqërisë nuk ka emëruar nëpunësin zbatues;

- Nuk ka hartuar dhe miratuar planin i cili përmban objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimi;

- Nuk ka një Kod të Brendshëm Etik ose një Kod Sjellje, rregullore, apo udhëzim për zbatimin e etikës, si dhe nuk ka procedurë për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara;
- Nuk ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari i shoqërisë, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre;
- Nuk ka një procedurë të veçantë për përmbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave;
- Nuk ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Riskut, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut, nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, pra nuk është identifikuar dhe krijuar një regjistër risku, vlerësimi, për kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave;
- Nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik të riskut, i cili duhet të kontrollojë si janë menaxhuar risqet brenda njësisë publike, si dhe të përgatisë raporte vjetore mbi problematikat e hasura;
- Nuk ka hartuar, miratuar, arkivuar Gjurmët e Auditimit, e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtarisë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to;
- Nuk ka procedura të përcaktuara të brendshme anti-korrupsion dhe të sinjalizimit të parregullsive;
- Nuk është hartuar dhe dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Deklarata dhe Raporti vjetor për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm;
- Nuk ka plotësuar dhe dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pyetësin e vetëvlerësimit, në funksion të realizimit të pesë fushave në të cilat funksionon menaxhimi financiar dhe kontrolli. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për organizimin dhe funksionin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit"*, i ndryshuar Neni 8 pika b germa a, neni 12 pika 1, neni 15, neni 16 pika 2 pika 3, neni 17 pika 1, neni 18 pika 1, neni 20 pika 2 germa a, neni 21 pika 2, neni 27 pika 2, Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010 Pika 2.2.8, pika 2.5.1, pika 3.1, pika 3.2 pika 4.2.8 sipas Kapitujve II, III, IV dhe Kapitulli V, Shtojca nr. 2 si dhe Udhëzimi nr. 28, datë 15.12.2011 *"Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë publike"* pika 15.

21.1 Rekomandimi: Nga Këshilli Mbikëqyrës të merren masat e menjëhershme në drejtim të implementimit në Rregulloren e Brendshme të Shoqërisë të Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, të miratohen rregullat e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm si dhe vënien e administratorit të shoqërisë dhe drejtuesve të tjerë kundrejt përgjegjësisë dhe detyrimit të marrjes së masave për implementimin e ligjit dhe njëkohësisht ndërgjegjësimin e të gjithë punonjësve për zbatimin e kërkesave të këtij Ligji, sa më sipër cituam dhe akteve të dala në funksion të tij. Nga administratori në cilësinë e Titullarit të Shoqërisë të merren masa për trajnimin e të gjithë stafit të shoqërisë në lidhje me kërkesat e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe vënien në efikasitet të sistemit të kontrollit të brendshëm.

Në vijimësi

Statusi i pranimit: Pranuar (pjesërisht)

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se për këtë rekomandim nuk janë marrë masa shtesë nga ana e Titullarit të Autoritetit Kontraktor. Në kushte të tilla ky rekomandim **konsiderohet i pranuar por i pazbatuar**.

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se:

- Nuk janë kryer përditshme për ndryshimet e kryera në rregulloret e brendshme mbi pozicionin e sekretar-arkivit si dhe nuk është përcaktuar sipas dispozitave ligjore kompetenca lidhur me mirëmbajtjen, ruajtjen, administrimin e vulës së Shoqërisë;

- Nga Zyra e Shërbimeve të Brendshme, sektor i cili mbulon arkivin, nuk është kryer kontrolli fizik i dokumentacionit arkivor të shoqërisë gjë e cila duhet të kryej çdo 6 muaj duke mbajtur procesverbalet përkatëse;

- Nga verifikimi i dosjeve të arkivit të Shoqërisë është konstatuar se janë evidentuar dokumentacione që kanë tejkaluar afatin kohor, të cilat duhen dorëzuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave;

- Për periudhën objekt auditimi nuk është kryer mbyllja e dosjeve të hapura sipas pasqyrës emërtuese brenda afateve të përcaktuara në ligj, mbi verifikimin e dokumenteve dhe saktësinë e afateve të ruajtjes. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për arkivat*", neni 4, neni 5 pika 6, neni 8, neni 25, neni 43, pika a, "*Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*", neni 43 si dhe Rregulloret e Brendshme të Shoqërisë miratuar respektivisht me Vendimin nr. 7, datë 04.04.2017 dhe Vendimin nr. 3, datë 19.03.2019.

22.1 Rekomandimi: Porti Detar Vlorë, Zyra e Shërbimeve të Brendshme, të marrë masa për kryerjen e përditësimeve në rregulloren e brendshme për përcaktimin e kompetencave mbi mirëmbajtjen, ruajtjen administrimin e vulës së shoqërisë, dorëzimin e dokumentacionit i cili ka tejkaluar afatin kohor në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, kontrollin fizik të dokumentacionit arkivor si dhe mbylljen e dosjeve të hapura sipas pasqyrës emërtuese brenda afateve të përcaktuara në ligj.

Në vijimësi

Statusi i pranimit: Pranuar

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se për këtë rekomandim nuk janë marrë masa shtesë nga ana e AK me përjashtim të nisjes së procesit të inventarizimit për dorëzimin në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave. Në kushte të tilla ky rekomandim **konsiderohet i pranuar por i zbatuar pjesërisht**.

23. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontratat e qirave të lidhura mes Portit Detar Vlorë SHA dhe subjekteve qiramarrës, në të gjitha rastet, si në ato të audituara dhe në ato të paaudituar plotësisht, kontratat e qirasë, konkretisht neni 2 Kushtet e Kontratës, paragrafi i fundit, janë lidhur në kundërshtim me VKM nr. 54 datë 05.02.2014 "*Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*", të ndryshuar, pasi kjo kontratë ka përcaktuar më pak kërkesa nga sa parashikohen në këtë pikë sipas VKM duke bërë kështu që Shoqëria të jetë e ekspozuar ndaj riskut të mundshëm të lidhjes së kontratave me subjekte që nuk ofrojnë garanci të plotë për përmbushjen e qëllimit të kontratës. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 54 datë 05.02.2014 "*Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*", i ndryshuar, Kreu II, pika 7.

23.1 Rekomandimi: Porti Detar Vlorë SHA të marrë masa për hartimin e kontratave të reja në përputhje me kërkesat e parashikuara nga kuadri rregullator përkatës duke rritur kështu kërkesat për subjekte të rregullta qiramarrëse.

Në vazhdimësi

Statusi i pranimi: Pranuar

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht kontratës me nr. 7 prot., datë 25.01.2021 e lidhur mes Portit Detar Vlorë dhe subjektit *Luan Karuli* rezulton se rekomandimi i mësipërm është zbatuar. Në kushte të tilla ky rekomandim **konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.**

24. Gjetje nga auditimi: Prej tetorit të vitit 2019 në Terminalin e ri ushtrojnë aktivitetin e tyre me qira 6 subjekte. Nga auditimi u konstatua se këto subjekte nuk shlyejnë detyrimet e energjisë elektrike pasi furnizohen nga sistemi qendror i terminalit dhe nuk kanë matës të instaluar në secilin subjekt për llogaritjen e shpenzimeve të energjisë elektrike. Konsumi i energjisë për këto subjekte për periudhën objekt auditimi është paguar nga Portit Detar Vlorë sha dhe jo nga subjektet me qira në kundërshtim me nenin 2 të Kontratës së qirasë.

24.1 Rekomandimi: Nga drejtoria e Portit Detar SHA Vlorë të merren masa për llogaritjen dhe mbajtjen e vlerës së shpenzimeve për energji elektrike nga subjektet me qira brenda terminalit për periudhën tetor-dhjetor 2019. Si dhe të instalohen matës të veçantë në çdo subjekt për përcaktimin e saktë të konsumit të energjisë elektrike në muajt në vazhdim.

Menjëherë

Statusi i pranimi: Pranuar

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në ambientet ku ushtrojnë aktivitet këto 6 subjekte nuk janë instaluar matësit por sipas një përlllogaritjeje nga ana e specialistit elektrikist z. Altin Xhaferaj, punonjës i Portit Detar Vlorë, në lidhje me konsumin mesatar mujor, është përdorur kjo sasi konsumi fikse për secilin nga këto subjekte brenda Terminalit të ri. Nga verifikimi i dokumentacionit të financës rezulton se kjo sasi konsumi është paguar nga subjektet qiramarrëse. Referuar kontratës së qirasë lidhur mes Portit Detar Vlorë dhe OAL – AUTO sipas aktit me nr. 510 prot., datë 30.12.2020, janë parashikuar pagesa e sasisë së energjisë sipas sasisë së përlllogaritur nga ana e ing. Altin Xhaferaj në masën prej 882 lekë/muaj. Në vijim, pas faturës tatimore me nr. 88367906, nr. 6, datë 01.02.2021 janë arkëtuar shumat përkatëse për këtë sasi konsumi në masën 1,058 lekë. Në vijim zbatimi i këtij rekomandimi ngelet për tu verifikuar nga grupet e auditimit të KLSH-së. Për sa i takon pagesave për muajt tetor – nëntor – dhjetor rezulton se nuk dokumentohet arkëtimi këtyre shumave për këto 6 subjekte. Në kushte të tilla ky rekomandim **konsiderohet i pranuar por i zbatuar pjesërisht.**

25. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontratat e qirave të lidhura mes Portit Detar Vlorë SHA dhe subjekteve qiramarrës, nga të cilat u audituan, për vitin 2018 – 9 kontrata me vlerë totale 2,225 mijë lekë nga 12 të tilla me vlerë totale të arkëtuar 2,472 mijë lekë (90 % të gjithë shumës së arkëtuar deri në fund të vitit), si dhe për vitin 2019 – 7 kontrata me vlerë totale 2,710 mijë lekë nga 16 të tilla me vlerë totale të arkëtuar 3,387 mijë lekë (80 % të gjithë shumës së arkëtuar deri në fund të vitit) u konstatuan në dosje mangësitë si më poshtë:

- Në 9 raste mungojnë plan bizneset;

- Në 5 raste mungojnë vërtetime nga institucionet përkatëse që subjektet nuk janë në ndjekje penale si dhe nuk kanë procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin si dhe treguesit që do të realizohen;

- Për 7 raste nga 9 të audituara për kontratat e vitit 2018, rezultoi se dokumentacioni i nevojshëm përpara lidhjes së kontratës është dorëzuar në Administratë, pas lidhjes së saj. Në këto dokumente të dorëzuara me vonesë rezulton të jetë edhe garancia e kontratës;

- Në 9 raste të vitit 2018 planimetritë janë hartuar pas datës së lidhjes së kontratës dhe jo përpara saj;

- Në 13 raste rezulton se nuk janë bërë arkëtimet në formën e garancisë 3 mujore për 8 subjekte në vitin 2018 në shumën 405,957 lekë dhe 4 subjekte për vitin 2019 në shumën 259,857 lekë.

- Në 2 raste, sipas dokumentacionit të dorëzuar nga subjektet qiramarrëse, këto subjekte konkretisht "RAMADAN FETA" dhe "OLIVER XHINDI" kanë rezultuar debitorë në tatime në momentin e lidhjes së kontratës, përkatësisht në shumën 13,848 lekë dhe 65,486 lekë;

- Në 2 raste, konkretisht në kontratat me subjektet qiramarrëse "EROIL" dhe "LUAN KARULI", nuk është paguar ngurtësimi në shumën e plotë të kontratës por është kryer pagesë vjetore;

- Në 4 raste, nga të cilat 3 në vitin 2018 në kontratat me subjektet "3 BBROKER", "OLIVER XHINDI" dhe "2A2F" dhe 1 në vitin 2019 në kontratën me subjektin "RAMADAN FETA" pagesat e kryera për 3 muaj qiraje paradhënieje janë konsideruar si garanci kontrate. Pas këtyre 3 muajve nga ana e këtyre subjekteve është vijuar me pagesat mujore duke mos ngurtësuar deri në fund garancinë e kontratës;

Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 54 datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar, Kreu II, pika 7 dhe pika 14 si dhe Kontratat e qiramarrjes, neni 6 Garancitë.

25.1 Rekomandimi: Porti Detar Vlorë SHA të marrë masa për hartimin e kontratave të reja në përputhje me kërkesat e parashikuara nga kuadri rregullator përkatës duke rritur kështu kërkesat për subjekte të rregullta qiramarrëse.

Në vijimësi

Statusi i pranimit: Pranuar

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht kontratës me nr. 7 prot., datë 25.01.2021 e lidhur mes Portit Detar Vlorë dhe subjektit Luan Karuli rezulton se rekomandimi i mësipërm është zbatuar. Në vijim, zbatimi i këtij rekomandimi ngelet për tu verifikuar nga grupet e auditimit të KLSH-së. Në kushte të tilla ky rekomandim **konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.**

B/I. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

1. Gjetje nga auditimi: Midis shoqërisë "Porti Detar" Vlorë dhe Operatori Ekonomik "Denisa Breshaj", i shpallur fitues me procedurën e prokurimit iniciuar me Urdhër prokurimi nr. 13 datë 26.02.2018 është lidhur kontrata e furnizimit nr. 173 datë 07.03.2018 me afat kohor deri në 14.03.2018 dhe me vlerë 138,000 lekë pa TVSh. Nga auditimi u konstatua se OE nuk ka dorëzuar mallin brenda afatit të përcaktuar në kontratë. Edhe pse nga autoriteti kontraktor është kërkuar me shkresën nr. 201 datë 23.03.2018, likuidimin vullnetar të penaltetit në masën 20% të vlerës së kontratës referuar nenit 13 të kontratës, OE nuk e ka likuiduar penaltetin në masën **27,600 lekë e cila përbën dëm ekonomik për shoqërinë.**

1.1 Rekomandimi: Porti Detar Vlorë SHA të marrë masat për kontabilizimin dhe ndjekjen në të gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimin e penaliteteve në shumën **27,600 lekë** dhe përjashtimin e operatorit ekonomik Denisa Breshaj nga të gjitha procedurat e prokurimit në të ardhmen.

Menjëherë

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht shkresës me nr. 85/39 prot., datë 09.06.2020 është njoftuar subjekti "*Merylin 2012*", (sipas rekomandimit është "*Denisa Breshaj*") në lidhje me detyrimin në shumën 27,600 lekë si ekzekutim vullnetar, në të kundërt është cituar ndjekja e rrugëve ligjore për arkëtimin e kësaj shume. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se sipas shkresës me nr. 110 prot., datë 12.02.2021 nga ana e Titullarit të AK është paraqitur kërkesë padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë me objekt detyrimin e palës së paditur në shumën 27,600 lekë. Në kushte të tilla ky **rekomandim konsiderohet si i pranuar por në proces zbatimi.**

2. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për kontratën me objekt "*Zgjerimi i Terminalit të Portit Detar Vlorë SHA*", për të cilën është lidhur kontrata bazë me nr. 776 prot., datë 23.12.2016 mes AK Porti Detar Vlorë SHA, e përfaqësuar nga Titullari z. Admir Malaj dhe sipërmarrësit të punimeve "*JUNIK*" ShPK, e përfaqësuar nga administratori z. Ded Malutaj me vlerë të kontratës 212,638,360 lekë pa TVSh ose 249,186,632 lekë me TVSh si dhe kontrata shtesë me nr. 520/3 prot., datë 26.10.2018 mes AK Porti Detar Vlorë SHA, e përfaqësuar nga Titullari z. Admir Malaj dhe sipërmarrësit të punimeve "*JUNIK*" ShPK, e përfaqësuar nga administratori z. Ded Malutaj me vlerë të kontratës 19,627,350 lekë pa TVSh ose 23,082,812 lekë me TVSh rezultoi se janë likuiduar zëra punimesh të pakryera në fakt dhe/apo zëra punimesh jo në përputhje me ato të pasqyruara në situacion. Konkretisht nga krahasimi i librezës së masave, situacionet përfundimtar si dhe verifikimit të kryer rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt apo në përputhje me zërin e përshkruar në situacion në shumën **1,367,832 lekë pa TVSh**. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, Kreu II, Pika 3, Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar me Udhëzimi Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3, Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 "*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*", Kreu I, pika 7, Kreu II, pikat 8.1 dhe 8.3, VKM nr. 514, datë 15/8/2007 "*Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit*", ndryshuar me VKM nr. 664, datë 26/9/2012, pika 8, kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes të lidhur sipas aktit me nr. nr. 07 prot., datë 06.01.2017, kontratën e shërbimit të kolaudimit të lidhur sipas aktit me nr. 785 prot., datë 28.12.2016 si dhe Urdhrin e Titullarit nr. 101 datë 20.03.2018 për monitorimin e zbatimit të kontratës së zbatimit të punimeve.

2.1 Rekomandimi Porti Detar Vlorë SHA të marrë masat për kontabilizimin dhe të ndiqen të gjitha shkallët e gjyqimit për shlyerjen e dëmit ekonomik në shumën **1,367,832 lekë pa TVSh** nga ana e OE "*JUNIK*" ShPK në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën bazë të lidhur sipas aktit me nr. 776 prot., datë 23.12.2016, me amendimet përkatëse si dhe kontratën shtesë me nr. 520/3 prot., datë 26.10.2018, mes tij dhe AK Port Detar Vlorë.

Menjëherë

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht shkresës me nr. 85/40 prot., datë 09.06.2020 është njoftuar subjekti "JUNIK" në lidhje me detyrimin në shumën **1,367,832 lekë** si ekzekutim vullnetar, në të kundërt është cituar ndjekja e rrugëve ligjore për arkëtimin e kësaj shume. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nga ana e Titullarit të AK nuk është zbatuar plotësisht rekomandimi pasi nuk janë ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ato ligjore në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin e shpërblimit të dëmit të rekomanduar nga ana e KLSH. Në kushte të tilla ky **rekomandim konsiderohet si i pranuar por i zbatuar pjesërisht.**

3. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për kontratën me objekt "*Zgjerimi i Terminalit të Portit Detar Vlorë SHA*", për të cilën është lidhur kontrata bazë me nr. 776 prot., datë 23.12.2016 mes AK Porti Detar Vlorë SHA, e përfaqësuar nga Titullari z. Admir Malaj dhe sipërmarrësit të punimeve "JUNIK" ShPK, e përfaqësuar nga administratori z. Ded Malutaj me vlerë të kontratës 212,638,360 lekë pa TVSh ose 249,186,632 lekë me TVSh si dhe kontrata shtesë me nr. 520/3 prot., datë 26.10.2018 mes AK Porti Detar Vlorë SHA, e përfaqësuar nga Titullari z. Admir Malaj dhe sipërmarrësit të punimeve "JUNIK" ShPK, e përfaqësuar nga administratori z. Ded Malutaj me vlerë të kontratës 19,627,350 lekë pa TVSh ose 23,082,812 lekë me TVSh rezultoi se në preventiv ofertën e hartuar nga ana e sipërmarrësit të punimeve në ofertën e paraqitur pranë Autoritetit Kontraktor janë paraqitur analiza kostoje duke konsideruar si punime ndërtimi edhe punimet për vendosjen e pajisjeve. Në fakt një metodë e tillë e përllogaritjes së koston është e gabuar pasi:

a. Furnizimi dhe vendosja e pajisjeve si UPS 20 UPS 20 kVA ,3f. 230V, 5 min i pavarur i montuar ne RAK, RACK lokal 12U, i montuar në mur me panel 24 portash, Switch 24 porta+ I fibër optike, Central alarm zjarri max 125 detektorë , Skaner me rreze X për bagazhet , Amplifikator 2x500 w. Mikrofon, Bokse në tavan etj. *nuk janë punime ndërtimi dhe si të tilla nuk mund ti nënshtrohen kësaj mënyrë të përllogaritjes së koston;*

b. Vlera e blerjes së të gjitha pajisjeve *nuk mund të përfshihet as tek shpenzimet e drejtpërdrejta dhe as tek shpenzimet e përgjithshme dhe si e tillë, vlerës së furnizimit me pajisje nuk mund ti shtohet vlera prej 8 % si shpenzim i përgjithshëm dhe as ajo prej 10 % si fitim për sipërmarrësin pasi nuk është as punim ndërtimi dhe as punim teknologjik por është punim montimi;*

Duke qenë se punimet e montimit, nuk janë punime ndërtimi të kategorisë *Punime ndërtimi* rezulton se edhe analiza e koston së hartuar nga ana e sipërmarrësit është kryer në kundërshtim me analizën e miratuar të strukturës së koston së punimeve të ndërtimit duke bërë që nga ana e sipërmarrësit të përfitohen tepër shuma prej **2,406,512 lekë pa TVSh.**

Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", nenit 1, nenit 2 dhe nenit 3, neni 7, neni 12, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, Kreu II, Pika 3, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3, Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 "*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*", Kreu I, pika 7, Kreu II, pikat 8.1 dhe 8.3, Udhëzimi nr. 2, datë 08.05.2003, në Kreun I, germa A PUNIME NDËRTIMIT, paragrafi i fundit, Kreu I, germa B Punime Teknologjike dhe të Montimit, Kreu II, Pika B Shpenzimet e Përgjithshme dhe Fitimi, kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes të lidhur sipas aktit me nr. nr. 07 prot., datë 06.01.2017 si dhe Urdhrin e Titullarit nr. 101 datë 20.03.2018 për monitorimin e zbatimit të kontratës së zbatimit të punimeve.

3.1 Rekomandimi: Porti Detar Vlorë SHA të marrë masat për kontabilizimin dhe të ndiqen të gjitha shkallët e gjykimit për shlyerjen e dëmit ekonomik në shumën **2,406,512 lekë pa TVSh** nga ana e OE “JUNIK” ShPK në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën bazë të lidhur sipas aktit me nr. 776 prot., datë 23.12.2016, me amendimet përkatëse si dhe kontratën shtesë me nr. 520/3 prot., datë 26.10.2018, mes tij dhe AK Port Detar Vlorë.

Menjëherë

Statusi i pranimi: Pranuar

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht shkresës me nr. 85/41 prot., datë 09.06.2020 është njoftuar subjekti “JUNIK” në lidhje me detyrimin në shumën **2,406,512 lekë** si ekzekutim vullnetar, në të kundërt është cituar ndjekja e rrugëve ligjore për arkëtimin e kësaj shume. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nga ana e Titullarit të AK nuk është zbatuar plotësisht rekomandimi pasi nuk janë ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ato ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin e shpërblimit të dëmit të rekomanduar nga ana e KLSH pasi është pushuar së vepruari në përpjekjen e tij për zbatimin e këtij rekomandimi. Në kushte të tilla ky **rekomandim konsiderohet si i pranuar por i zbatuar pjesërisht.**

4. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi në terren i ambienteve të terminalit të ri dhe territorit të Portit Detar Vlorë, në ambientet e hyrjes perëndimore të Portit mbi ambientet e oficinës u konstatua prezenca e dy tabelave reklame me dimensione 2 copë x 8 m x 3,75 m = 60 m². Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se sipas aktit me nr. 437/2 prot., datë 31.08.2018 është lidhur një kontratë mes Titullarit të AK z. Admir Malaj dhe subjektit IRIS ShPK me objekt vendosjen e tabelave të reklamave brenda territorit të Portit. Sipas kësaj kontrate dhe konkretisht, aktmarrëveshjes me nr. 437/1 prot., datë 31.08.2018 janë parashikuar vendosja e 10 reklamave. Konstatohet se kjo akt marrëveshje është lidhur mes përfaqësuesve të Portit Detar Vlorë SHA Shefit të Zyrës së Marketingut dhe Shefes së Degës Teknike dhe Investimeve znj. Eva Çuka dhe përfaqësuesit të “IRIS” ShPK Pëllumb Panariti. Në fakt, ky dokument nuk ka bazë ligjore pasi të dy punonjësit e mësipërm e kanë lidhur këtë aktmarrëveshje në emër të Portit Detar Vlorë dhe si të tillë nuk kanë tagër ligjor për lidhjen e akteve të tilla. Sipas marrëveshjes mbi të cilën edhe është lidhur kontrata për vendosjen e reklamave, janë përcaktuar në total 10 reklama me sipërfaqe prej 16 m². Në fakt nga verifikimi në terren i tabelave në hyrjen perëndimore rezulton se këto 2 tabela kanë sipërfaqe prej të paktën 60 m². Nga sa më sipër rezulton se janë përfituar tepër nga subjekti IRIS ShPK shuma **73,333 lekë**, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik dhe si e tillë duhet arkëtuar nga IRIS ShPK. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Kreu III, neni 166 si dhe Statutin e Shoqërisë, neni 19 si dhe me kontratën nr. 437/1 prot., datë 31.08.2018.

4.1 Rekomandimi: Porti Detar Vlorë SHA të marrë masat për kontabilizimin dhe të ndiqen të gjitha shkallët e gjykimit për shlyerjen e dëmit ekonomik në shumën **73,333 lekë pa TVSh** nga ana e “IRIS” ShPK në cilësinë e subjektit qiramarrës në kontratën e lidhur sipas aktit me nr. 437/1 prot., datë 31.08.2018.

Menjëherë

Statusi i pranimi: Pranuar

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht mandat pagesës me datë 14.04.2020 është kryer kjo pagesë në shumën **73,333 lekë** në favor të subjektit Porti Detar Vlorë SHA. Në kushte të tilla ky **rekomandim konsiderohet si i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.**

5. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi në terren i ambienteve të terminalit të ri dhe territorit të Portit Detar Vlorë u konstatua se në ambientet e terminalit të ri, janë vendosur 2 tabela reklame me dimensione 3 m x 2 m nga subjekti privat ABI Bankë SHA. Lidhur me këtë rast nga AK Porti Detar Vlorë disponohet një Kontratë Sponsorizimi e lidhur me ABI Bankë SHA, Portit Detar Vlorë SHA dhe subjektit Arbian Safa, person fizik. Objekti i kësaj kontrate është sponsorizimi i Portit me shirita ndarës të radhës së klientëve me një gjatësi 80 m dhe 40 copë këmbë për mbajtjen e shiritave të mësipërm. Shuma e sponsorizuar nga Banka do të jetë në masën 2,600 € dhe do ti paguhet subjektit fizik Arbian Safa pas përgatitjes së materialeve dhe vendosjes së tyre në Terminalin e ri. Sipas nenit 5 *Të drejtat dhe detyrimet e palëve*, pika 2 janë parashikuar vendosja e 1 tabele dhe jo 2 të tillave për një periudhë prej 5 vitesh. Nga sa më sipër rezulton se nga ana e subjektit *“ABI BANK”* nuk është arkëtuar shuma prej **60,000 lekë** për efekt të një tabele reklame më shumë nga ajo e parashikuar në Kontratën e Sponsorizimit. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 *“Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”*, Kreu III, neni 166, Statutin e Shoqërisë, neni 19 si dhe me kontratën e sponsorizimit të lidhur mes palëve.

5.1 Rekomandimi: Porti Detar Vlorë SHA të marrë masat e duhura duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **60,000 lekë pa TVSh** nga ana e *“ABI BANK”* për efekt vendosjen e një tabele reklame më tepër nga ato të parashikuara në kontratën e sponsorizimit.

Menjëherë

Statusi i pranimit: Pranuar

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht shkresës me nr. 85/38 prot., datë 09.06.2020 është njoftuar subjekti *“ABI BANK”* në lidhje me detyrimin në shumën **60,000 lekë** si ekzekutim vullnetar, në të kundërt është cituar ndjekja e rrugëve ligjore për arkëtimin e kësaj shume. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se është ndërprerë kontrata e sponsorizimit mes *“ABI BANK”* dhe Portit Detar Vlorë SHA dhe në vend të shumës prej 60,000 lekë është mbajtur sinjalistika (shiritat ndarës) me gjatësi prej 80 m dhe 40 copë mbajtëse shiritash, vlera e investimit të së cilës është në masën 2,600 €, ose shuma prej gati 317,200 lekë. Në kushte të tilla ky **rekomandim konsiderohet si i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.**

B/II. MASA PËR SHMANGIEN E TË ARDHURA TË MUNGUARA.

1. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi në terren i ambienteve të terminalit të ri dhe territorit të Portit Detar Vlorë u konstatua se në ambientet e terminalit të ri, janë vendosur 2 tabela reklame me dimensione 3 m x 2 m nga subjekti privat ABI Bankë SHA. Lidhur me këtë rast nga AK Porti Detar Vlorë disponohet një Kontratë Sponsorizimi e lidhur me ABI Bankë SHA, Portit Detar Vlorë SHA dhe subjektit Arbian Safa, person fizik. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se nga ana e Administratës së Portit Detar Vlorë **nuk është bërë një analizë e detajuar** me qëllim krahasimin e investimit prej 2,600 € të kryer nga ana e subjektit ABI Bank dhe përfitimeve të mundshme nga dhënia me qira e ambienteve për reklama. Duke iu referuar çmimeve të miratuara për tarifat e reklamave rezulton se nga të ardhurat e siguruara, të paktën nga dy tabelat me dimensione 3 m x 2 m, të vendosura sipas kontratës për 5 vite, do të ishin:

$2 \text{ tabela} \times 2 \text{ krahë të ekspozuar} \times 3^m \times 2^m \times 5^{\text{vite}} \times 5,000 \text{ lekë/m}^2 \times \text{vit} = 600,000 \text{ lekë}$

(çmimi 5,000 lekë/m² x vit është marrë nga vendimi i Këshillit Mbikëqyrës i vitit 2016)

Në përfitim të subjektit sponzorisues janë vendosur edhe shiritat e ndarjes së kalimit të pasagjerëve për të cilat nuk është specifikuar një metodologji arkëtimi për efekt reklame. Për rrjedhojë, vlera e Kontratës së Sponsorizimit prej 2,600 €, ose shuma 317,200 lekë (1 € = 122

lekë) është gati 2 herë më e vogël nga shuma e cila mund të ishte arkëtuar realisht nga Porti Detar Vlorë në krye në 5 viteve. **Vlera prej 600,000 lekë përbën të ardhura të munguara** për buxhetin e shoqërisë për këtë 5 vjeçar.

Gjithashtu, në dosje nuk disponohen dokumente për periudhën 01.01.2019 – 31.12.2019, afat për të cilin nuk rezulton të jenë arkëtuar të ardhura nga qiraja në shumën **300,000 lekë, vlerë kjo e cila përbën të ardhura të munguara** për shkak të mos arkëtimit të tarifës së ekspozimit të reklamave nga subjektet private. Aktualisht, dy tabelat janë të ekspozuara me reklama të subjektit privat “EURONEWS” dhe në lidhje me këtë nuk rezulton të jenë kryer arkëtime në favor të Portit Detar Vlorë SHA. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Kreu III, neni 166 si dhe Statutin e Shoqërisë, neni 19.

1.1 Rekomandimi: Porti Detar Vlorë SHA të marrë masa për:

- Rishikimin e kontratës së sponsorizimit me qëllim shmangien e efekteve financiare negative siç është ajo në shumën prej **600,000 lekë** për buxhetin e shoqërisë në 5 vitet e ardhshme;
- Vjeljen e tarifave të reklamave konform sipërfaqes së dhënë me qira duke marrë në konsideratë edhe ato të vendosura në Terminalin e Ri;
- Shmangien e efekteve financiare negative siç është ajo e rastit të tabelave të reklamave mbi ambientin e oficinës për të cilën për të paktën periudhën 01.01.2019 – 31.12.2019 duhet të ishin arkëtuar shuma prej **300,000 lekë**.

Në vazhdimësi

Statusi i pranimi: Pranuar

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton se është ndërprerë kontrata e sponsorizimit mes “ABI BANK” dhe Portit Detar Vlorë SHA dhe shuma e cilësuar si e ardhur e munguar në masën prej **600,000 lekë** për 5 vjeçarin e ardhshëm të parashikuar në kontratën e sponsorizimit me nr. 299 prot., datë 29.07.2019 nuk konsiderohet më si e tillë. Gjithashtu, nga verifikimi në terren rezultoi se është hequr tabela e subjektit privat “EURONEWS” për të cilin ishin konstatuar të ardhura të munguara nga qiraja në shumën **300,000 lekë**. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet si i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.

B/III. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi, për mos ndjekjen e procedurave ligjore në ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ish punonjësit, Porti Detar sha Vlorë është paditur nga 11 persona, nga të cilët 4 çështje janë në proces gjykimi, dhe 7 procedura kanë përfunduar duke e detyruar Portin Vlorë të paguajë vlerën 4,657,584 lekë (dëmshpërblim + shpenzime gjyqësore) vlerë e cila përbën efekt financiar negativ për shoqërinë Porti Vlorë. Nga kjo vlerë, theksojmë se vlera 420,598 lekë, përbëhet nga shpenzime përmbarimore, për arsye se punonjësit të cilët i fitojnë procedurat gjyqësore kanë ndjekur përmbarimin për ekzekutimin e vendimit. **Vlera 420,598 lekë përbën përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe economicitet të fondeve** për buxhetin e shoqërisë.

1.1 Rekomandim: Porti Detar Vlorë SHA të marrë masat për shmangien në të ardhëm të largimeve të padrejta nga puna me qëllim eliminimin e efekteve me impakt negativ për buxhetin e Shoqërisë.

Menjëherë

Statusi i pranimi: Pranuar (pjesërisht)

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht dy kërkesave dhe urdhrave për largim nga puna, rezulton se gjatë periudhës në vijim nuk ka pasur asnjë zgjidhje të njëanshme të kontratës së punës nga ana e punëdhënësit. Largimet nga puna janë bërë më dëshirën e punëmarrësve ose për shkak të daljes në pension. Në kushte të tilla ky **rekomandim konsiderohet si i pranuar dhe i zbatuar plotësisht**.

2. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi, për mos ndjekjen e procedurave ligjore në ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ish punonjësit, Porti Detar sha Vlorë është paditur nga 11 persona, nga të cilët 4 çështje janë në proces gjykim, dhe 7 procedura kanë përfunduar duke e detyruar Portin Vlorë të paguajë vlerën **4,657,584 lekë** (dëmshpërblim + shpenzime gjyqësore) **vlerë e cila përbën efekt financiar negativ** për shoqërinë Porti Vlorë. Theksojmë se, sa më sipër është një rast i përsëritur nga drejtoria e shoqërisë pasi dhe në auditimin e mëparshëm të KLSH nr. 1133/8, datë 24.04.2018 në shoqërinë “Porti Detar Vlorë”, është konstatuar e njëjta problematikë, por nuk është marrë asnjë masë mbi ndjekjen e procedurave ligjore për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe shmangien e shpenzimeve gjyqësore të kësaj natyre.

2.1 Rekomandimi: Administratori dhe Zyra e Burimeve Njerëzore në shoqërinë Porti Detar SHA Vlorë, të marrin masa të menjëhershme për zbatimin e rregullave dhe procedurave, si dhe dokumentimin e tyre, në rastet e marrjes së masave disiplinore, largimit nga detyra, apo pushimit të menjëhershëm të punonjësve nga puna.

Menjëherë

Statusi i pranimit: Pranuar (pjesërisht)

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht dy kërkesave dhe urdhrave për largim nga puna, rezulton se gjatë periudhës në vijim nuk ka pasur asnjë zgjidhje të njëanshme të kontratës së punës nga ana e punëdhënësit. Largimet nga puna janë bërë më dëshirën e punëmarrësve ose për shkak të daljes në pension. Gjithashtu, në rastin e dhënies së 8 masave disiplinore të rekomanduara nga KLSH, rezulton se janë ndjekur procedurat e duhura. Në kushte të tilla ky **rekomandim konsiderohet si i pranuar dhe i zbatuar plotësisht**.

3. Gjetje nga auditimi: Në kartelat përkatëse të mjeteve, në të cilat regjistrohen të gjitha të dhënat e automjetit si dhe shpenzimet që do të kryhen për to, nuk është evidentuar kilometrazhi i tij në fillim të vitit dhe në fund të vitit për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike për goma, filtra e vaj, karburant, riparime etj. Këto shpenzime nuk mund të përlllogariten pa pasqyruar elementin bazë i cili është kilometrazhi, për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e tyre. Nga verifikimi dhe llogaritja e të dhënave të dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se, janë tërhequr me tepër 4927 litra naftë në vlerën 812,955 lekë, të cilat nuk janë të plotësuara me dokumentacion. Sasia e tërhequr e karburantit ose vlera **812,955 lekë e cila përbën efekt negativ financiar për buxhetin e shoqërisë** nuk përputhet me kilometrat e përshkuara dhe nuk justifikohet me dokumentacion mbështetës. Administratori në cilësinë e Titullarit dhe nëpunësit autorizues, Shefi i Zyrës së Administrimit Financiar në cilësinë e nëpunësit zbatues si dhe Dega Teknike dhe Investimeve, e caktuar për menaxhimin e aktiveve konstatohet se, nuk kanë marrë masa për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për monitorimin dhe mbrojtjen e aktiveve të shoqërisë dhe nuk janë kryer kontrole për llogaritjen e konsumit real të karburantit. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit” i ndryshuar, Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar si dhe pika 5, pika 10, pika 19, pika 35

germa a, b, c, pika 36, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar.

4.1 Rekomandimi: Porti Detar Vlorë, Zyra e Administrimit Financiar, Dega Teknike dhe Investimeve, të marrë masat për monitorimin e shpenzimeve të karburantit, në mënyrë kronologjike, me qëllim përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të tij. Nga Dega Teknike dhe Investimeve, në kartelat përkatëse të automjeteve të evidentohen dhe përditësohen të gjitha të dhënat si dhe të kryhet ky riparimi në automjetet në të cilat janë konstatuar defekte në aparatin e kilometrazhit.

Menjëherë

Statusi i pranimit: Pranuar

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht evidencës me së hartuar nga ana e Ing. Agron Muçaj, me detyrë përgjegjëse i oficinës janë marrë masat për monitorimin e shpenzimeve të karburantit, në mënyrë kronologjike përgjatë muajve. Gjithashtu, konstatohet se nuk janë marrë masa për riparimin në automjetet në të cilat janë konstatuar defekte në aparatin e kilometrazhit. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet si i pranuar plotësisht por i zbatuar pjesërisht.

4. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontratat e qirave të lidhura mes Portit Detar Vlorë SHA dhe subjekteve qiramarrës, nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se në 1 rast në kontratën e lidhur me subjektin qiramarrës "KRENAR DELIAJ" rezulton se është bërë ndërprerja e kontratës jo në përputhje me kushtet e saj. Konkretisht rezulton se kërkesa për ndërprerje për shkak të kushteve ekonomike të qiramarrësit është bërë në datë 07.02.2018. Sipas korrespondencave rezulton se ndërprerja e kontratës duhet të ishte kryer jo më herët se data 06.04.2018, afat në të cilin Porti Detar Vlorë do të kishte arkëtuar shumën prej 80,166 lekë prej subjektit qiramarrës. Në kushte të tilla nga ana e Portit Detar Vlorë, duhet të ishte analizuar saktë kjo situatë dhe për ndërprerje të njëanshme të kontratës në kundërshtim me parashikimet e bëra në nenin 7 të saj të arkëtonte shumën prej **195,000 lekë**, por kjo shumë nuk ka qenë e ngurtësuar në formën e garancisë. Nga sa më sipër rezulton se është favorizuar padrejtësisht subjekti qiramarrës nëpërmjet lidhjes së kontratës me mangësi në dokumentacion, duke lidhur kontratë pa ngurtësuar më parë sigurimin e kontratës si dhe duke lejuar lidhjen e një kontrate të re pa respektuar afatin për ndërprerje të kontratës së parë. Sa më sipër është në kundërshtim me Kontratën e qirasë e lidhur sipas aktit me nr. 951/1 prot., datë 03.01.2018, neni 7.

5.1 Rekomandimi: Porti Detar Vlorë SHA të marrë masa për shmangien e ndërprerjes së kontratave në mënyrë të parakohshme dhe/apo të njëanshme nga ana e subjekteve qiramarrëse me qëllim shmangien e efekteve negative për buxhetin e shoqërisë si ai në shumën **195,000 lekë** i trajtuar më sipër.

Në vijimësi

Statusi i pranimit: Pranuar

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nuk ka patur më ndërprerje të parakohshme të kontratave të qirasë. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet si i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.

C/I. PALIGJSHMËRI NË REALIZIMIN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT

1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se për periudhën objekt auditimi janë realizuar në total dhe audituar në masën 100 % të tyre procedura si më poshtë:

2018

- 1 procedurë prokurimi e llojit *Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës* me vlerë të fondit limit 19,627,350 lekë pa TVSh për të cilën është lidhur kontrata me vlerë 19,627,350 lekë pa TVSh;

2019

- 1 procedurë prokurimi e llojit *Kërkesë për Propozime* me vlerë të fondit limit 2,213,314 lekë pa TVSh për të cilën është lidhur kontrata me vlerë 2,213,314 lekë pa TVSh;

- 1 procedurë prokurimi e llojit *Shërbim Konsulence* me vlerë të fondit limit 10,167,010 lekë pa TVSh për të cilën është lidhur kontrata me vlerë 9,600,000 lekë pa TVSh;

26. Nga këto 3 procedura prokurimi, në DST janë vendosur kritere të paargumentuara dhe/apo jo në përputhje me objektin e prokurimit. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, neni 1 "*Objekti dhe qëllimi*" pika 2, germa (a), (b), (c), (ç), (d) dhe (dh), neni 20, neni 46, neni 48, pika 4, paragrafi i dytë, neni 51, pika 1, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", ndryshuar, Kreu I, neni 11, pika 3, germa b, neni 26, pika 3, pika 5, Kreu II, Seksioni 2, neni 27, pika 2, neni 58, paragrafi i fundit, neni 61, pika 2 si dhe VKM nr. 410 datë 13.05.2015 "*Për Krijimin, Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial*", Kreu I Krijimi i Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial, pika 1. Gjithashtu, në 2 raste, përkatësisht në procedurën e vitit 2018 dhe në procedurën e karburantit të vitit 2019, nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave janë kualifikuar OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e veçanta të kualifikimit. Në këto 2 raste, procedurat e prokurimit duhet të ishin anuluar dhe të rinisnin një të re. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, neni 1 "*Objekti dhe qëllimi*" pika 2, germa (a), (b), (c), (ç), (d) dhe (dh), neni 20, neni 46, neni 53, pika 3 dhe 5, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "*Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*", i ndryshuar, neni 66, VIII, 74 Bashkimi i operatorëve ekonomikë, pika 3 si dhe VKM nr. 410 datë 13.05.2015 "*Për Krijimin, Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial*", Kreu I Krijimi i Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial, pika 1. Si rrjedhojë vlera prej **32,007,674 lekë pa TVSh** përbën paligjshmëri në realizimin e procedurave të prokurimit.

14.1 Rekomandimi: Komisionet e ngritura për hartimin e Kritereve të Përgjithshme/Veçanta të marrin masat e duhura për të vendosur si kushte për kualifikim vetëm kritere të domosdoshme dhe të lidhura drejtpërdrejtë me Investimin / mallin / shërbimin.

Në vazhdimësi

Statusi i pranimit: Pa pranuar

C/II. PAGESA TË KRYRA NË MËNYRË JO TË RREGULLT

(për punime të pakryera në momentin e likuidimit)

1. **Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për objektin "*Zgjerimi i Terminalit të Portit Detar Vlorë SHA*", është lidhur kontrata bazë me nr. 776 prot., datë 23.12.2016 mes AK Porti Detar Vlorë SHA, e përfaqësuar nga Titullari z. Admir Malaj dhe sipërmarrësit të punimeve "*JUNIK*" ShPK, e përfaqësuar nga administratori z. Ded Malutaj me vlerë të kontratës 212,638,360 lekë pa TVSh ose 249,186,632 lekë me TVSh si dhe kontrata shtesë me nr. 520/3 prot., datë 26.10.2018 mes AK Porti Detar Vlorë SHA, e përfaqësuar nga Titullari z. Admir Malaj dhe sipërmarrësit të punimeve "*JUNIK*" ShPK, e përfaqësuar nga

administratori z. Ded Malutaj me vlerë të kontratës 19,627,350 lekë pa TVSh ose 23,082,812 lekë me TVSh.

Duke qenë se në auditimin e mëparshëm, zbatimi i kësaj kontrate është audituar për pjesën progresive deri në fund të periudhës objekt auditimi (deri më 31.10.2017) pasi ka rezultuar në proces, në vijim paraqiten konstatimet vetëm për periudhën objekt auditimi. Konkretisht rezultoi se janë situacionuar nga sipërmarrësi punime të pakryera në fakt në momentin e situacionimit në shumën 44,214,972 lekë pa TVSh. Nga këto **rezulton e likuiduar për punime të pakryera në fakt në momentin e likuidimit shuma 37,165,900 lekë pa TVSh**. Situacionimi dhe likuidimi i punimeve të pakryera në fakt në momentin e likuidimit të tyre, përbën një veprimtari krejtësisht fiktive dhe është fenomen diskriminues për OE të tjerë, për sa kohë pagesa të tilla nuk janë parashikuar në formë të rregullt ligjore si parapagime në Dokumentet Standarde të Tenderit. Gjithashtu, veprime të tilla fiktive denatyrojnë krejtësisht procesin e prokurimit pasi vetë AK, në zbatim të LPP dhe RrPP vendos kriter në lidhje me kapacitetet teknike dhe ekonomike që duhet të kenë OE pjesëmarrës në procedurat e prokurimit kur në fakt, siç edhe është shprehur më sipër, një pjesë e pagesave pjesore kryen për punime të situacionuara por të pakryera ende në fakt. Kjo praktikë pagese është konstatuar edhe në auditimin e mëparshëm, ku pagesat për këtë kontratë kanë qenë në fillim të punimeve, por që me këtë formë pagese ka vijuar deri në përfundim të saj. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*" të ndryshuar, neni 1, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3, Udhëzimi nr. 2 datë 13.05.2005 "*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*", Kreu II, pika 8, Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 07 prot., datë 06.01.2017 si dhe Urdhri i Titullarit nr. 101 datë 20.03.2018 për monitorimin e zbatimit të kontratës.

1.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës i Portit Detar Vlorë SHA të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive në lidhje me pagesën e kryer për punime të situacionuara e të likuiduara dhe njëkohësisht të pakryera në fakt në momentin e likuidimit. Gjithashtu, të rrisë efektivitetin e monitorimit të kontratave me qëllim shmangien e pagesave për punime të tilla.

Në vijimësi

Statusi i pranimi: Pranuar

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton së në lidhje me këtë rekomandim nuk është marrë asnjë masë për nxjerrjen e përgjegjësive në lidhje me pagesën e kryer për punime të situacionuara e të likuiduara dhe njëkohësisht të pakryera në fakt në momentin e likuidimit. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet si i pranuar por i pa zbatuar.

D. MASA ADMINISTRATIVE:

D/1. Për Agjencinë e Prokurimit Publik.

- Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, përcaktuar në Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, neni 1 "*Objekti dhe qëllimi*" pika 2, germa (a), (b), (c), (ç), (d) dhe (dh), neni 20, neni 46, neni 53, pika 3 dhe 5, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "*Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*", i ndryshuar, neni 66, VKM nr. 354 datë 11.05.2016 "*Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim*", VKM nr. 408 datë 13.05.2013 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*" si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuara dhe pasqyruara në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar, bazuar në

nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë**, Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Hartimi i projekt-preventivit të zbatimit për tenderin ‘Rikonstruksion i kalatës lindore në Portin Detar Vlorë’” dhe të vendosë masë administrative me gjobë për punonjësit si më poshtë:

- A. Znj. **Eva Çuka** në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
 - B. Znj. **Matilda Panahori** në cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
 - C. Z. **Dhimitri Papa** në cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
- për shkeljet e konstatuara në shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave.

Statusi i pranimit: Pranuar (pjesërisht)

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se me shkresën e administruar në APP me nr. 3075/5 prot., datë 26.06.2020 është dërguar Vendimi i APP në lidhje me dënimin me gjobë në masën 50,000 lekë vetëm për punonjësin z. Isuf Hilaj. Në vijim, pas kërkesës së bërë nga ana e punonjësit për pagesën e kësaj shume me këste (10 këste), është pranuar kjo kërkesë nga ana e Titullarit sipas shkresës së datës 01.07.2020. Referuar borderove për muajt gusht e në vijim janë bërë ndalesat përkatëse. Nisur nga fakti se nga ana e KLSH i është kërkuar APP është njëkohësisht vlerësimi i shkeljeve të konstatuara në lidhje me procedurën *Hartimi i projekt-preventivit të zbatimit për tenderin ‘Rikonstruksion i kalatës lindore në Portin Detar Vlorë’*” dhe vendosja nga institucioni e masave administrative me gjobë dhe në fund vendimmarrja sipas shkresës nr. 3075/5 prot., datë 26.06.2020 ka qenë dhënia e masës vetëm për një person, ky rekomandim konsiderohet si i pranuar dhe i zbatuar.

D/2. Për Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes Territorit (IKMT).

- Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar, mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë**, Portit Detar Vlorë SHA, t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Vlorë, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të vendosë masë administrative me gjobë:

1. Subjektit “**IMES - D**” ShPK me përfaqësues ligjor Ibrahim Dragoshi, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.1641/6 në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve;
 2. Subjektit “**GOLD CONSTRUCTION**” me përfaqësuese ligjore Diana Progri, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.1945/11 datë 23.03.2018 në cilësinë e kolaudatorit të punimeve;
- për shkeljet e konstatuara në zbatimin e punimeve të investimit me objekti “**Zgjerimi i Terminalit të Portit Detar Vlorë SHA**”.

Statusi i pranimit: Pranuar

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se me shkresat nr. 85/37 prot., datë 09.06.2020 është dërguar nga ana e Titullarit njoftimi për marrjen e masave administrative ndaj subjekteve "IMES – D" dhe "GOLF CONTRUCTION" drejtuar Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vlorë. Sipas deklarimeve të bëra nga ana e punonjësve të Portit Detar Vlorë rezulton se aktualisht nuk ka asnjë kthim përgjigjeje nga ana e këtij institucioni në lidhje me marrjen e masave administrative me gjobë ndaj dy subjekteve të rekomanduara nga ana e KLSH. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet si i pranuar por i zbatuar pjesërisht.

E. MASA DISIPLINORE:

E/1. Për punonjësit me kontratë.

Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas kodit të punës.

F.I Mbështetur në nenin 37 të "Kodit të Punës" si dhe nenit 5 të Kontratës "Për administrimin dhe drejtimin e shoqërisë Porti Detar sha Vlorë", lidhur ndërmjet Këshillit Mbikëqyrës "Porti Detar sha Vlorë" dhe Drejtorisë së Portit Detar sha Vlorë, i kërkojmë Këshillit Mbikëqyrës së Portit Detar Vlorë, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore pas analizimit të të gjitha shkeljeve të kryera, për personat si më poshtë:

1. Admir Malaj me detyrë Administrator i shoqërisë Porti Detar sha Vlorë, pasi:

- Në cilësinë e Titullarit të shoqërisë gjatë periudhës objekt auditimi nuk ka marrë masa efektive për zbatimin e rekomandimit të lënë nga auditimi i mëparshëm në lidhje monitorimin e zbatimit të kontratës me objekt "Zgjerimi i Terminalit të Portit Detar Vlorë SHA" duke bërë që në mënyrë të përsëritur të lejohet kryerja e pagesave në shumën **37,165,900 lekë pa TVSh** për punime të pakryera në fakt në momentin e likuidimit të këtyre situacioneve pjesore.

- Në cilësinë e Titullarit në mënyrë të përsëritur nuk është marrë asnjë masë mbi ndjekjen e procedurave ligjore për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe shmangien e shpenzimeve gjyqësore të kësaj natyre duke i shkaktuar shoqërisë shpenzime të shpenzuara **pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet në vlerën 4,657,584 lekë.**

- Nuk ka marrë masa për implementimin e Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, pasi ky ligj nuk njihet nga strukturat drejtuese të shoqërisë e punonjësit e saj, nuk ka funksionuar në asnjë hallkë të njësisë dhe për pasojë, drejtuesit nuk kanë bërë një vlerësim të efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Masën për Titullarin ja rekomandojmë Këshillit Mbikëqyrës për shkeljet dhe mangësitë e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit pasi të analizojë materialin e paraqitur dhe të marrë vendimin përkatës, vendim ky të cilin KLSH do ta shqyrtojë në ardhmen.

Statusi i pranimit: Pa pranuar

F.II Mbështetur në nenin 37 të "Kodit të Punës" si dhe Kontratës Individuale të Punës, lidhur ndërmjet Drejtorisë së Portit Detar SHA Vlorë dhe punonjësve, i kërkojmë Këshillit Mbikëqyrës dhe Administratorit, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore nga "Vërejtje me shkrim" deri në "Largim nga detyra" pas analizimit të të gjitha shkeljeve të kryera, për personat si më poshtë:

2. Daniel Muaj me detyrë Shef i zyrës së Administrimit Financiar, pasi:

- Në cilësinë e Shefit të Zyrës së Administrimit Financiar nuk ka kryer pagesën mbi shtesën për vjetërsinë në punë për vitet 2018 dhe 2019, konkretisht në vlerën 111,600 lekë në total për vitin 2019 dhe në vlerën 199,440 lekë në total për vitin 2018.

- Në cilësinë e Shefit të zyrës së Administrimit Financiar nuk ka kryer planifikimin vjetor të shpenzimeve për personelin bazuar në të dhëna faktike të Shoqërisë.
- Në cilësinë e Shefit të zyrës së Administrimit Financiar për dy kontrata blerje me vlerë të vogël në shumën totale 660,300 lekë pa TVSh, nuk ka kryer likuidimet brenda afateve të përcaktuara në kontratë.
- Në cilësinë e Shefit të Zyrës së Administrimit Financiar nuk ka kryer pasqyrimin e rezervave të rivlerësimit në pasqyrën e pozicionit financiar për vitin 2018.
- Në cilësinë e Shefit të Zyrës së Administrimit Financiar nuk ka kryer pasqyrimin e ndryshimeve në kontabilitet në pasqyrat financiare pas daljes jashtë përdorimit të zërit Mallra për rishitje.
- Në cilësinë e Shefit të Zyrës së Administrimit Financiar gjatë hartimit të pasqyrave financiare, shënimet shpjeguese nuk janë hartuar sipas kuadrit rregullator ligjor.
- Në cilësinë e Shefit të Zyrës së Administrimit Financiar nuk ka marrë masat e duhura për respektimin e kontratave të qirasë në 13 raste ku rezulton se nuk janë bërë arkëtimet në formën e garancisë 3 mujore, në 2 raste pagesat për ngurtësimet janë kryer me këste, në 3 raste shuma e deklaruar si e ngurtësuar është përdorur si pagesë për muajt pasardhës duke mos kryer pagesat vijuese, etj.

- Në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në një rast ka miratuar kualifikimin dhe shpalljen fitues të OE me mangësi në dokumentacion;

3. Znj. Eva Çuka, në cilësinë e Shefit të Degës Teknike dhe Investimeve, pasi:

- Në cilësinë e Shefit të Degës Teknike si dhe anëtarit të Komisionit të marrjes në dorëzim të punimeve të përfunduara në kontratën me objekt *“Zgjerimi i Terminalit të Portit Detar Vlorë SHA”* rezultoi se në mënyrë të përsëritur pas konstatimeve të bëra nga auditimi i mëparshëm për të njëjtën kontratë zbatimi, janë situacionuar nga sipërmarrësi punime të pakryera në fakt në shumën 44,214,972 lekë pa TVSh. Nga këto, rezulton e likuiduar për punime të pakryera në fakt në momentin e likuidimit shuma 37,165,900 lekë pa TVSh;

- Në cilësinë e Shefit të Degës Teknike si dhe anëtarit të Komisionit të marrjes në dorëzim të punimeve të përfunduara në kontratën në kontratën e përmendur më sipër, rezultoi një dëm ekonomik në shumën **3,774,344 lekë pa TVSh** nga të cilat:

a. Vlera **1,367,832 lekë pa TVSH** si rrjedhojë e miratimit të situacioneve me punime të pakryera;

b. Vlera **2,406,512 lekë pa TVSH** lekë si rrjedhojë e miratimit të likuidimit të punimeve të montimit të pajisjeve si punime të mirëfillta ndërtimi;

- Në cilësinë e hartuesit të specifikimeve teknike në procedurën e prokurimit me objekt *“Kryerja e punimeve shitesë të paparashikuara në objektin ‘Zgjerimi i terminalit të Pasagjerëve’”*, rezultoi se ka vendosur kriterë konfuze dhe jo në lidhje me nevojat e investimit;

- Në cilësinë e anëtarit të komisionit të Vlerësimit të Ofertave në procedurën e prokurimit me objekt *“Rikonstruksion i kalatës lindore në Portin Detar Vlorë”* ku rezultoi se ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE me mangësi në dokumentacion duke mos plotësuar kështu Kriteret e Veçanta të Kualifikimit;

4. Z. Isuf Hilaj, specialist, pasi;

- Në cilësinë e anëtarit të Komisionit të marrjes në dorëzim të punimeve të përfunduara në kontratën me objekt *“Zgjerimi i Terminalit të Portit Detar Vlorë SHA”* rezultoi se në mënyrë të përsëritur pas konstatimeve të bëra nga auditimi i mëparshëm për të njëjtën kontratë zbatimi, janë situacionuar nga sipërmarrësi punime të pakryera në fakt në shumën 44,214,972 lekë pa TVSh. Nga këto, rezulton e likuiduar për punime të pakryera në fakt në momentin e likuidimit shuma 37,165,900 lekë pa TVSh;

- Në cilësinë e anëtarit të Komisionit të marrjes në dorëzim të punimeve të përfunduara në kontratën në kontratën e përmendur më sipër, rezultoi një dëm ekonomik në shumën **3,774,344 lekë pa TVSh** nga të cilat:

a. Vlera **1,367,832 lekë pa TVSh** si rrjedhojë e miratimit të situacioneve me punime të pakryera;
b. Vlera **2,406,512 lekë pa TVSh** lekë si rrjedhojë e miratimit të likuidimit të punimeve të montimit të pajisjeve si punime të mirëfillta ndërtimi;

- Në cilësinë e hartuesit të specifikimeve teknike në procedurën e prokurimit me objekt *“Kryerja e punimeve shitesë të paparashikuara në objektin 'Zgjerimi i terminalit të Pasagjerëve’”*, rezultoi se ka vendosur kritere konfuze dhe jo në lidhje me nevojat e investimit;

- Në cilësinë e anëtarit të komisionit të Vlerësimit të Ofertave në procedurën e prokurimit me objekt *“Rikonstruksion i kalatës lindore në Portin Detar Vlorë”*, rezultoi se ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE me mangësi në dokumentacion duke mos plotësuar kështu Kriteret e Veçanta të Kualifikimit;

F.III Mbështetur në nenin 37 të “Kodit të Punës” si dhe Kontratës Individuale të Punës, lidhur ndërmjet Drejtorisë së Portit Detar SHA Vlorë dhe punonjësve, Këshillit Mbikëqyrës dhe Administratorit të Portit Detar Vlorë, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Vërejtje me paralajmërim” pas analizimit të të gjitha shkeljeve të kryera, për personat si më poshtë:

5. Z. Klodian Berisha, në cilësinë e Shefit të Degës së Marketingut;

6. Z. Aulon Veizi, në cilësinë e specialistit të marketingut;

7. Znj. Axiola Bozhani, në cilësinë e specialistit të Kontratave dhe Vlerësimit të Riskut;

- Për shkeljet e konstatuara nga auditimi i kontratave të qirasë nga ku rezultuan se:

a. Në 9 raste mungojnë plan bizneset

b. Në 5 raste mungojnë vërtetime nga institucionet përkatëse që subjektet nuk janë në ndjekje penale si dhe nuk kanë procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin si dhe treguesit që do të realizohen;

c. Për 7 raste nga 9 të audituara për kontratat e vitit 2018, rezultoi se dokumentacioni i nevojshëm përpara lidhjes së kontratës është dorëzuar në Administratë, pas lidhjes së saj. Në këto dokumente të dorëzuara me vonesë rezulton të jetë edhe garancia e kontratës;

d. Në 9 raste të vitit 2018 planimetritë janë hartuar pas datës së lidhjes së kontratës dhe jo përpara saj;

e. Në 13 raste rezulton se nuk janë bërë arkëtimet në formën e garancisë 3 mujore për 11 subjekte

f. Në 2 raste, sipas dokumentacionit të dorëzuar nga subjektet qiramarrëse, këto subjekte kanë rezultuar debitorë në tatime në momentin e lidhjes së kontratës, përkatësisht në shumën 13,848 lekë dhe 65,486 lekë;

g. Në 2 raste, nuk është paguar ngurtësimi në shumën e plotë të kontratës por është kryer pagesë vjetore;

h. Në 4 raste, nga të cilat 3 në vitin 2018 dhe 1 në vitin 2019 pagesat e kryera për 3 muaj qiraje paradhënieje janë konsideruar si garanci kontrate. Pas këtyre 3 muajve nga ana e këtyre subjekteve është vijuar me pagesat mujore duke mos ngurtësuar deri në fund garancinë e kontratës;

i. Të gjitha kontratat e qirasë, konkretisht neni 2 Kushtet e Kontratës, paragrafi i fundit, janë lidhur në kundërshtim me VKM nr. 54 datë 05.02.2014 *“Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”*, të ndryshuar, pasi këto kontrata kanë përcaktuar më pak kërkesa nga sa parashikohen në këtë pikë sipas VKM.

8. **Znj. Mestjona Banushaj**, në cilësinë e Shefit të Zyrës Juridike, pasi:

- Në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit për tenderin *“Rikonstruktion i kalatës lindore në Portin Detar Vlorë”* ka hartuar dokumente tenderi në kundërshtim me parimet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efijencës të shprehura në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”*, neni 5;

- Në cilësinë e personit përgjegjës për prokurimin për procedurën me objekt *“Blerje Karburanti 2019”* nuk janë marrë masa për:

a. Emërimin me urdhër të ri të anëtarëve të NJP dhe KVO pas anulimit të procedurës së parë të prokurimit duke vijuar me Urdhrat dhe emërimet e mëparshme;

b. Procesverbalin e argumentimit të llojit të procedurës;

c. Lidhjen e kontratës mes AK Porti Detar Vlorë dhe BOE të shpallur fitues ende pa dorëzuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm pas shpalljes të tij si fitues i procedurës;

9. **Znj. Matilda Panahori**, specialiste, pasi:

- Në cilësinë e anëtares së KVO dhe të Komisionit të marrjes në dorëzim të projektit për tenderin *“Rikonstruktion i kalatës lindore në Portin Detar Vlorë”* rezultuan mangësi si përgjatë kualifikimit të OE të shpallur fitues edhe gjatë marrjes në dorëzim të projektit.

Statusi i pranimit: Pranuar (pjesërisht)

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton si më poshtë:

Nr.	Emri i Punonjësit	Pozicioni	Rekomanduar	Zbatuar	Urdhri
1	Daniel Muaj	Shef i zyrës së Administrimit Financiar	“Vërejtje me shkrim” deri në “Largim nga detyra”	Vërejtje me shkrim	Nr. 103 datë 04.06.2020 me nr. 204/2 prot., datë 04.06.2020
2	Eva Çuka	Shefit të Degës Teknike dhe Investimeve	“Vërejtje me shkrim” deri në “Largim nga detyra”	Vërejtje me shkrim	Nr. 107 datë 04.06.2020 me nr. 201/4 prot., datë 04.06.2020
3	Isuf Hila	Specialist	“Vërejtje me shkrim” deri në “Largim nga detyra”	Vërejtje me shkrim	Nr. 109 datë 04.06.2020 me nr. 201/3 prot., datë 04.06.2020
4	Klodian Berisha	Shefit të Degës së Marketingut	“Vërejtje” deri në “Vërejtje me paralajmërim”	Vërejtje	Nr. 104 datë 04.06.2020 me nr. 202/2 prot., datë 04.06.2020
5	Aulon Veizi	Specialist	“Vërejtje” deri në “Vërejtje me paralajmërim”	Vërejtje	Nr. 106 datë 04.06.2020 me nr. 202/3 prot., datë 04.06.2020
6	Axhiola Bozhani	Specialiste	“Vërejtje” deri në “Vërejtje me paralajmërim”	Vërejtje	Nr. 105 datë 04.06.2020 me nr. 202/3 prot., datë 04.06.2020
7	Mestjona Banushaj	Shefit të Zyrës Juridike	“Vërejtje” deri në “Vërejtje me paralajmërim”	Vërejtje	Nr. 102 datë 04.06.2020 me nr. 203/2 prot., datë 04.06.2020
8	Matilda Panahori	Specialiste	“Vërejtje” deri në “Vërejtje me paralajmërim”	Vërejtje	Nr. 108 datë 04.06.2020 me nr. 201/2 prot., datë 04.06.2020

Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet si i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.

IV KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Në përfundim të procesit të auditimit, nga Porti Detar SHA Vlorë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën e saj nr. 974/8 prot., datë 18.05.2020, konstatohet se pjesa më me peshë e tyre është e pazbatuar ose e zbatuar pjesërisht. Duke parë punën e pamjaftueshme të bërë në drejtim të zbatimit të tyre, **rikërkojmë** të vazhdojnë procedurat ligjore, si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga Auditimi (*sipas gjetjes 1 të Masave Organizative*): Nga auditimi i masave të marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, ka rezultuar se nga subjekti “Porti Detar”, Vlorë sha nuk janë pranuar 3 rekomandime, janë pranuar por nuk janë zbatuar 2 si dhe janë zbatuar por pjesërisht 5 rekomandime në kundërshtim me nenet 15 dhe 16 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të shtetit. Konkretisht si në tabelën e më poshtme:

Rekomandime	Rekomanduar	Pranuar	Të pa pranuar	Realizuar	Realizuar pjesërisht	Në proces	Të pa zbatuara
Përmirësime ligjore	-	-	-	-	-	-	-
Masa organizative	17	17	-	8	5	3	1
Masa shpërbllim dëmi	6	5	1	3	-	2	1
M.D.ekonomik pamundësi arkëtimi	1	1	-	-	-	-	1
Masa për elimin.....	4	2	2	1	-	1	2
Masa disiplinore	12	12	-	12	-	-	-
Totali	40	37	3	24	5	6	4
Totali në %		93%	8%	60%	13%	15%	10%

Në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë Porti Detar Vlorë janë pranuar 37 nga 40 rekomandime. Nga këto, 5 janë zbatuar pjesërisht duke mos përmirësuar plotësisht proceset e punës dhe për 1 rekomandim nuk është marrë ende asnjë masë për tu zbatuar.

1.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë Porti Detar SHA Vlorë, të marrë masa të menjëhershme për rishikimin dhe zbatimin e të gjitha masave të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH. Të rishikohen rekomandimet të cilat janë zbatuar pjesërisht, që nuk janë pranuar si dhe ato që janë pranuar dhe nuk janë zbatuar ende.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi (*sipas gjetjes 5 të Masave Organizative*): Nga auditimi i borderosë së pagave për vitet 2018-2019 u konstatua se paga bazë mbi të cilën llogariteshin sigurimet shoqërore e shëndetësore dhe tatimet nuk përfshinte shtesën për vjetërsinë e punës 1-2% në vit referuar kontratës kolektive të punës dhe niveli të pagave të miratuar në Programin Ekonomik 2018 dhe 2019. Nga zyra e financës nuk është llogaritur dhe nuk është paguar shtesa për vjetërsi në punë konkretisht në vlerën 111,600 lekë në total për vitin 2018 dhe në vlerën 199,440 lekë në total për vitin 2019.

-Në kontratat individuale të punës të hartuara nga zyra e Burimeve Njerëzore nuk specifikohet paga e punonjësve në kundërshtim me Kontratën Kolektive dhe Kodin e Punës. Për sa kohë që përcaktimi i pagës për çdo punonjës bëhet referuar pozicionit të punës, kualifikimit të diplomës dhe vjetërsisë në punë, paga duhet të specifikohet në çdo kontratë individuale dhe jo vetëm në shkresat e emërimit.

-Nga auditimi i strukturës së miratuar si dhe rregullores së miratuar me vendimin Nr. 3 datë 19.03.2019 të Këshillit Mbikëqyrës u konstatua se në disa pozicione të strukturës organizative nuk është përcaktuar niveli dhe lloji i arsimit që kërkohet për pozicionin si dhe në rregullore nuk janë përcaktuar kriteret bazë për çdo pozicion. Nisur nga fakti se pjesë përbërëse e pagës bazë

është “paga e grupit” e cila jepet në formë shpërblimi për nivelin e diplomës përcaktimi i kriterëve arsimore dhe profesionale për secilin pozicion përbën domosdoshmëri. Gjithashtu nga auditimi i procedurave: të rekrutimit, lëvizjet paralele dhe ngritja në detyrë të punonjësve u konstatua se, nuk janë parashikuar procedura rekrutimi në rregulloren e shoqërisë si dhe nuk zbatohet asnjë procedurë përzgjedhjeje. Rekrutimi dhe lëvizjet brenda shoqërisë bëhen vetëm me shkresa emërimi nga Administratori i shoqërisë.

2.1 Rekomandimi: Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës të marrin masa të menjëhershme për përcaktimin në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të shoqërisë Porti Detar SHA Vlorë, të kriterëve të përshtatshme për çdo pozicion pune, si dhe publikimin e vendeve vakante dhe ndjekjen e procedurave për një proces cilësor dhe të drejtë të rekrutimit dhe zhvillimit profesional të punonjësve.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi (sipas gjetjes 6 të Masave Organizative): Në shkresat e Asamblesë Aksionare për vitet 2017, 2018 dhe 2019 është pasqyruar tabela përmbledhëse e shpenzimeve të miratuara për programin ekonomik përkatës ku përcaktohet numri i punonjësve, paga mesatare dhe fondi i pagave. Nga auditimi u konstatua se në tabelën përmbledhëse të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për Programet Ekonomik të viti 2017 numri total i punonjësve është 120, për vitin 2018 numri total i punonjësve është 121 dhe për vitin 2019 numri total i punonjësve të miratuar është 121. Ndërkohë referuar Programit Ekonomik analitik për të tre vitet nga Shoqëria janë punësuar dhe 15 punonjës “Ngarkim-shkarkimi” si punonjës me kohë të pjesshme duke e çuar numrin e punonjësve në total për vitin 2017 në 135 dhe për vitin 2018 dhe 2019 në 136. Gjithashtu, në tabelën përmbledhëse të miratuar nga Asambleja aksionare në zërin “Fondi i pagave” për vitin 2017, 2018 dhe 2019 përfshihen vetëm shpenzimet “Paga bruto” për punonjësit me kohë të plotë dhe jo për punonjësit me kontratë të cilët referuar kodit të punës duhet të trajtohen njësoj si punonjësit me kohë të plotë dhe shpenzimet për punonjësit me kohë të pjesshme duhet të jenë pjesë e “fondit të pagave” për shoqërinë. Nisur nga sa më sipër konstatohet se MFE dhe Ministria e linjës edhe pse janë shprehur parimisht dakord me përmbajtjen e Programit ekonomik për vitet 2017, 2018 dhe 2019 në tabelat përmbledhëse të miratuara nga Asambleja Aksionare nuk kanë përfshirë punonjësit me kontratë për të cilët shpenzimet e pagave janë respektivisht 3,744,000 lekë për vitin 2018 dhe 4,056,000 lekë për vitin 2019 ose 7,800,000 lekë në total. Nga ana e shoqërisë nuk janë përfshirë në programin ekonomik shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore të punonjësve me kohë të pjesshme për të bërë të mundur trajtimin financiar në përputhje me kontratat përkatëse dhe në respektim të të drejtave të përcaktuara në Kodin e Punës me qëllim shmangien e diskriminimit dhe trajtimin e barabartë të punonjësve.

3.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Portit Detar Vlorë SHA të marrin masa për përfshirjen në planifikim dhe miratim të programit ekonomiko-financiar të zërit “fondi i pagave” edhe shpenzimet për punonjësit me kohë të pjesshme, me qëllim trajtimin e plotë financiar të tyre ku të përfshihet jo vetëm paga bruto, por edhe detyrimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore, me qëllim për të dhënë sigurinë e trajtimit të barabartë të punonjësve. Gjithashtu organet drejtuese të shoqërisë në vijimësi të marrin masa për të bërë të mundur përfshirjen e punonjësve me kohë të pjesshme në organikën e shoqërisë dhe trajtimin e tyre si punonjës jo me kohë të pjesshme.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi (*sipas gjetjes 9 të Masave Organizative*): Në raportin e auditimit për vitin 2018, audituesit e pasqyrave financiare kanë dhënë Opinion me rezervë. Por nga auditimi i këtij raporti dhe letrës drejtuar drejtimit të shoqërisë, konstatohet se opinionin e auditimit në pasqyrat financiare, nuk është pasqyruar qartë dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) 250 “Mbajtja Parasysh e Ligjeve dhe Rregullave në një Auditim të Pasqyrave Financiare”. Kjo konstatohet dhe nga fakti se ky raport është ridorëzuar për herë të dytë pasi, Asambleja Aksionare ka konstatuar problematika në raportin e auditimit, duke kërkuar riformulimin e opinionit të audituesve të pavarur.

Në pasqyrat e vitit 2018, zëri Mallra për rishitje paraqiten në vlerën 8,264,765. Kjo gjendje vazhdon që prej vitit 2017 e pandryshuar edhe pse gjatë vitit 2017 kanë dal materiale jashtë përdorimit në vlerën 65,702 lekë, nuk janë pasqyruar në kontabilitet si shitje në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Standardet kombëtare të kontabilitetit.

4.1 Rekomandimi: Përgjegjësi i Zyrës së Financës të marrë masa për llogaritjen dhe pasqyrimin e ndryshimeve në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare pas daljes jashtë përdorimit të zërit Mallra për rishitje.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi (*sipas gjetjes 12 të Masave Organizative*): Administratori dhe sektori i financës në përgatitjen e pasqyrave financiare, kanë përdorur norma për llogaritjen e shpenzimeve të amortizimit të aktiveve afatgjata materiale, specifike të veprimtarisë portuale, të pa vlerësuar dhe aprovuara nga Këshilli Mbikëqyrës, në kundërshtim me Ligjin Nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” Neni 5, 9, “Mbajtja e kontabilitetit”, ku citohet se “Të gjitha njësitë ekonomike e organizojnë mbajtjen e kontabilitetit mbi bazën e parimeve dhe të metodave, që përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit; “Respektimi i standardeve kontabël”, 1. Pasqyrat financiare paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri gjendjen financiare, performancën, ndryshimet në gjendjen financiare dhe rrjedhjen e parasë së njësisë ekonomike. Pasqyrat financiare përgatiten dhe paraqiten në përputhje me standardet kontabël” dhe Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 1, pika 103, ku citohet se: Disa të dhëna financiare, të paraqitura në pasqyrat financiare, bazohen në vlerësime të bëra nga drejtuesit e njësisë ekonomike,...” dhe Standardi Kombëtar i Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale”, pika 39 citon se “Çdo njësi ekonomike cakton metodat e amortizimit dhe normat e amortizimit në politikat dhe procedurat e saj kontabël, të cilat duhet të përdoren për amortizimin e aktiveve afatgjata materiale”.

5.1 Rekomandimi: Nga Drejtimi i shoqërisë të merren masa për aprovimin e normave, të mbështetura këto në studime dhe vlerësime për jetëgjatësinë e aktiveve afatgjata materiale, nga specialistët e fushës dhe brenda limiteve ligjore.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi (*sipas gjetjes 13 të Masave Organizative*): Lidhur me ekzistencën dhe lëvizjen e aktiveve të qëndrueshme kemi konstatuar se për vitet 2017 dhe 2018 Shoqëria nuk ka hartuar regjistër kontabël të përditësuar të aktiveve që zotëron apo që ka në administrim, i cili në varësi të llojit të përmbajtjes kërkesat minimale si datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e

akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Për vitin 2019 regjistri kontabël nuk është mbajtur sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Sa më sipër është në kundërshtim me Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, Pikat 26 deri në 33.

6.1 Rekomandimi: Porti Detar Vlorë, të marrë masa nëpërmjet strukturave përgjegjëse të Shoqërisë, për të bërë të mundur sa më parë hartimin e regjistrave kontabël të aktiveve, të cilat të jenë sipas formateve të kërkuara dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi (*sipas gjetjes 21 të Masave Organizative*): Nga shoqëria Porti Detar Vlorë nuk është zbatuar Ligji për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin si dhe nuk është implementuar në Rregulloren e Brendshme të saj. Ligji nuk njihet nga strukturat drejtuese të shoqërisë e punonjësit e saj dhe për pasojë nuk ka funksionuar në asnjë hallkë të njësisë ku drejtuesit nuk kanë bërë një vlerësim të efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

- Për periudhën nga data 06.09.2017 deri më 13.12.2018 Administratori në cilësinë e Titullarit të Shoqërisë nuk ka emëruar nëpunësin zbatues;
- Nuk ka hartuar dhe miratuar planin i cili përmban objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit;
- Nuk ka një Kod të Brendshëm Etik ose një Kod Sjellje, rregullore, apo udhëzim për zbatimin e etikës, si dhe nuk ka procedurë për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara;
- Nuk ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari i shoqërisë, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre;
- Nuk ka një procedurë të veçantë për përmbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave;
- Nuk ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Riskut, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut, nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollat që synojnë minimizimin e riskut, pra nuk është identifikuar dhe krijuar një regjistër risku, vlerësimi, për kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave;
- Nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik të riskut, i cili duhet të kontrollojë si janë menaxhuar risqet brenda njësisë publike, si dhe të përgatisë raporte vjetore mbi problematikat e hasura;
- Nuk ka hartuar, miratuar, arkivuar Gjurmët e Auditimit, e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtarisë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to;
- Nuk ka procedura të përcaktuara të brendshme anti-korrupsion dhe të sinjalizimit të parregullsive;
- Nuk është hartuar dhe dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Deklarata dhe Raporti vjetor për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm;
- Nuk ka plotësuar dhe dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pyetësonin e vetëvlerësimit, në funksion të realizimit të pesë fushave në të cilat funksionon menaxhimi financiar dhe kontrolli. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010

“Për organizimin dhe funksionin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit”, i ndryshuar Neni 8 pika b germa a, neni 12 pika 1, neni 15, neni 16 pika 2 pika 3, neni 17 pika 1, neni 18 pika 1, neni 20 pika 2 germa a, neni 21 pika 2, neni 27 pika 2, Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010 Pika 2.2.8, pika 2.5.1, pika 3.1, pika 3.2 pika 4.2.8 sipas Kapitujve II, III, IV dhe Kapitulli V, Shtojca nr. 2 si dhe Udhëzimi nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë publike” pika 15.

7.1 Rekomandimi: Nga Këshilli Mbikëqyrës të merren masat e menjëhershme në drejtim të implementimit në Rregulloren e Brendshme të Shoqërisë të Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, të miratohen rregullat e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm si dhe vënien e administratorit të shoqërisë dhe drejtuesve të tjerë kundrejt përgjegjësisë dhe detyrimit të marrjes së masave për implementimin e ligjit dhe njëkohësisht ndërgjegjësimin e të gjithë punonjësve për zbatimin e kërkesave të këtij Ligji, sa më sipër cituam dhe akteve të dala në funksion të tij. Nga administratori në cilësinë e Titullarit të Shoqërisë të merren masa për trajnimin e të gjithë stafit të shoqërisë në lidhje me kërkesat e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe vënien në efikasitet të sistemit të kontrollit të brendshëm.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi (sipas gjetjes 22 të Masave Organizative): Nga auditimi rezultoi se:

- Nuk janë kryer përditshme për ndryshimet e kryera në rregulloret e brendshme mbi pozicionin e sekretar-arkivit si dhe nuk është përcaktuar sipas dispozitave ligjore kompetenca lidhur me mirëmbajtjen, ruajtjen, administrimin e vulës së Shoqërisë;
- Nga Zyra e Shërbimeve të Brendshme, sektor i cili mbulon arkivin, nuk është kryer kontrolli fizik i dokumentacionit arkivor të shoqërisë gjë e cila duhet të kryej çdo 6 muaj duke mbajtur procesverbalet përkatëse;
- Nga verifikimi i dosjeve të arkivit të Shoqërisë është konstatuar se janë evidentuar dokumentacione që kanë tejkaluar afatin kohor, të cilat duhen dorëzuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave;
- Për periudhën objekt auditimi nuk është kryer mbyllja e dosjeve të hapura sipas pasqyrës emërtuese brenda afateve të përcaktuara në ligj, mbi verifikimin e dokumenteve dhe saktësinë e afateve të ruajtjes. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, neni 4, neni 5 pika 6, neni 8, neni 25, neni 43, pika a, “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 43 si dhe Rregulloret e Brendshme të Shoqërisë miratuar respektivisht me Vendimin nr. 7, datë 04.04.2017 dhe Vendimin nr. 3, datë 19.03.2019.

8.1 Rekomandimi: Porti Detar Vlorë, Zyra e Shërbimeve të Brendshme, të marrë masa për kryerjen e përditësimeve në rregulloren e brendshme për përcaktimin e kompetencave mbi mirëmbajtjen, ruajtjen administrimin e vulës së shoqërisë, dorëzimin e dokumentacionit i cili ka tejkaluar afatin kohor në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, kontrollin fizik të dokumentacionit arkivor si dhe mbylljen e dosjeve të hapura sipas pasqyrës emërtuese brenda afateve të përcaktuara në ligj.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi (sipas gjetjes 24 të Masave Organizative): Prej tetorit të vitit 2019 në Terminalin e ri ushtrojnë aktivitetin e tyre me qira 6 subjekte. Nga auditimi u konstatua se këto subjekte nuk shlyejnë detyrimet e energjisë elektrike pasi furnizohen nga sistemi qendror i

terminalit dhe nuk kanë matës të instaluar në secilin subjekt për llogaritjen e shpenzimeve të energjisë elektrike. Konsumi i energjisë për këto subjekte për periudhën objekt auditimi është paguar nga Portit Detar Vlorë sha dhe jo nga subjektet me qira në kundërshtim me nenin 2 të Kontratës së qirasë.

9.1 Rekomandimi: Nga drejtoria e Portit Detar SHA Vlorë të merren masa për llogaritjen dhe mbajtjen e vlerës së shpenzimeve për energji elektrike nga subjektet me qira brenda terminalit për periudhën tetor-dhjetor 2019. Si dhe të instalohen matës të veçantë në çdo subjekt për përcaktimin e saktë të konsumit të energjisë elektrike në muajt në vazhdim.

Menjëherë

B/I. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

1. Gjetje nga auditimi (*sipas gjetjes 2 të Masave për Shpërbllim Dëmi*): Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për kontratën me objekt “Zgjerimi i Terminalit të Portit Detar Vlorë SHA”, për të cilën është lidhur kontrata bazë me nr. 776 prot., datë 23.12.2016 mes AK Porti Detar Vlorë SHA, e përfaqësuar nga Titullari z. Admir Malaj dhe sipërmarrësit të punimeve “JUNIK” ShPK, e përfaqësuar nga administratori z. Ded Malutaj me vlerë të kontratës 212,638,360 lekë pa TVSh ose 249,186,632 lekë me TVSh si dhe kontrata shtesë me nr. 520/3 prot., datë 26.10.2018 mes AK Porti Detar Vlorë SHA, e përfaqësuar nga Titullari z. Admir Malaj dhe sipërmarrësit të punimeve “JUNIK” ShPK, e përfaqësuar nga administratori z. Ded Malutaj me vlerë të kontratës 19,627,350 lekë pa TVSh ose 23,082,812 lekë me TVSh rezultoi se janë likuiduar zëra punimesh të pakryera në fakt dhe/apo zëra punimesh jo në përputhje me ato të pasqyruara në situacion. Konkretisht nga krahasimi i librezës së masave, situacionet përfundimtar si dhe verifikimit të kryer rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt apo në përputhje me zërin e përshkruar në situacion në shumën **1,367,832 lekë pa TVSh**. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu II, Pika 3, Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimi Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3, Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu I, pika 7, Kreu II, pikat 8.1 dhe 8.3, VKM nr. 514, datë 15/8/2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me VKM nr. 664, datë 26/9/2012, pika 8, kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes të lidhur sipas aktit me nr. nr. 07 prot., datë 06.01.2017, kontratën e shërbimit të kolaudimit të lidhur sipas aktit me nr. 785 prot., datë 28.12.2016 si dhe Urdhrin e Titullarit nr. 101 datë 20.03.2018 për monitorimin e zbatimit të kontratës së zbatimit të punimeve.

1.1 Rekomandimi Porti Detar Vlorë SHA të marrë masat për kontabilizimin dhe të ndiqen të gjitha shkallët e gjykitimit për shlyerjen e dëmit ekonomik në shumën **1,367,832 lekë pa TVSh** nga ana e OE “JUNIK” ShPK në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën bazë të lidhur sipas aktit me nr. 776 prot., datë 23.12.2016, me amendimet përkatëse si dhe kontratën shtesë me nr. 520/3 prot., datë 26.10.2018, mes tij dhe AK Port Detar Vlorë.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi (*sipas gjetjes 3 të Masave për Shpërbllim Dëmi*): Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për kontratën me objekt “Zgjerimi i Terminalit të Portit Detar Vlorë SHA”, për të cilën është lidhur kontrata bazë me nr. 776 prot., datë 23.12.2016 mes

AK Porti Detar Vlorë SHA, e përfaqësuar nga Titullari z. Admir Malaj dhe sipërmarrësit të punimeve “JUNIK” ShPK, e përfaqësuar nga administratori z. Ded Malutaj me vlerë të kontratës 212,638,360 lekë pa TVSh ose 249,186,632 lekë me TVSh si dhe kontrata shtesë me nr. 520/3 prot., datë 26.10.2018 mes AK Porti Detar Vlorë SHA, e përfaqësuar nga Titullari z. Admir Malaj dhe sipërmarrësit të punimeve “JUNIK” ShPK, e përfaqësuar nga administratori z. Ded Malutaj me vlerë të kontratës 19,627,350 lekë pa TVSh ose 23,082,812 lekë me TVSh rezultoi se në preventiv ofertën e hartuar nga ana e sipërmarrësit të punimeve në ofertën e paraqitur pranë Autoritetit Kontraktor janë paraqitur analiza kostoje duke konsideruar si punime ndërtimi edhe punimet për vendosjen e pajisjeve. Në fakt një metodë e tillë e përlogaritjes së kostos është e gabuar pasi:

c. Furnizimi dhe vendosja e pajisjeve si UPS 20 UPS 20 kVA ,3f. 230V, 5 min i pavarur i montuar ne RAK, RACK lokal 12U, i montuar në mur me panel 24 portash, Switch 24 porta+ 1 fibër optike, Central alarm zjarri max 125 detektorë , Skaner me rreze X për bagazhet , Amplifikator 2x500 w. Mikrofon, Bokse në tavan etj. *nuk janë punime ndërtimi dhe si të tilla nuk mund ti nënshtrohen kësaj mënyrë të përlogaritjes së kostos;*

d. Vlera e blerjes së të gjitha pajisjeve *nuk mund të përfshihet as tek shpenzimet e drejtpërdrejta dhe as tek shpenzimet e përgjithshme dhe si e tillë, vlerës së furnizimit me pajisje nuk mund ti shtohet vlera prej 8 % si shpenzim i përgjithshëm dhe as ajo prej 10 % si fitim për sipërmarrësin pasi nuk është as punim ndërtimi dhe as punim teknologjik por është punim montimi;*

Duke qenë se punimet e montimit, nuk janë punime ndërtimi të kategorisë *Punime ndërtimi* rezulton se edhe analiza e kostos së hartuar nga ana e sipërmarrësit është kryer në kundërshtim me analizën e miratuar të strukturës së kostos së punimeve të ndërtimit duke bërë që nga ana e sipërmarrësit të përfitohen tepër shuma prej **2,406,512 lekë pa TVSh.**

Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, nenit 1, nenit 2 dhe nenit 3, neni 7, neni 12, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu II, Pika 3, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafi 3.2 dhe 3.3, Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu I, pika 7, Kreu II, pikat 8.1 dhe 8.3, Udhëzimi nr. 2, datë 08.05.2003, në Kreun I, germa A PUNIME NDËRTIMIT, paragrafi i fundit, Kreu I, germa B Punime Teknologjike dhe të Montimit, Kreu II, Pika B Shpenzimet e Përgjithshme dhe Fitimi, kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes të lidhur sipas aktit me nr. nr. 07 prot., datë 06.01.2017 si dhe Urdhrin e Titullarit nr. 101 datë 20.03.2018 për monitorimin e zbatimit të kontratës së zbatimit të punimeve.

2.1 Rekomandimi: Porti Detar Vlorë SHA të marrë masat për kontabilizimin dhe të ndiqen të gjitha shkallët e gjykimit për shlyerjen e dëmit ekonomik në shumën **2,406,512 lekë pa TVSh** nga ana e OE “JUNIK” ShPK në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën bazë të lidhur sipas aktit me nr. 776 prot., datë 23.12.2016, me amendimet përkatëse si dhe kontratën shtesë me nr. 520/3 prot., datë 26.10.2018, mes tij dhe AK Port Detar Vlorë.

Menjëherë

B/II. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi (*sipas gjetjes 3 të Masave për Eliminimin e Efekteve Negative*): Në kartelat përkatëse të mjeteve, në të cilat regjistrohen të gjitha të dhënat e automjetit si dhe shpenzimet që do të kryhen për to, nuk është evidentuar kilometrazhi i tij në fillim të vitit dhe në fund të vitit për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike për goma, filtra e vaj, karburant, riparime etj. Këto shpenzime nuk mund të përlllogariten pa pasqyruar elementin bazë i cili është kilometrazhi, për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e tyre. Nga verifikimi dhe llogaritja e të dhënave të dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezultoi se, janë tërhequr me tepër 4927 litra naftë në vlerën 812,955 lekë, të cilat nuk janë të plotësuara me dokumentacion. Sasia e tërhequr e karburantit ose vlera **812,955 lekë e cila përbën efekt negativ financiar për buxhetin e shoqërisë** nuk përputhet me kilometrat e përshkuara dhe nuk justifikohet me dokumentacion mbështetës. Administratori në cilësinë e Titullarit dhe nëpunësit autorizues, Shefi i Zyrës së Administrimit Financiar në cilësinë e nëpunësit zbatues si dhe Dega Teknike dhe Investimeve, e caktuar për menaxhimin e aktiveve konstatohet se, nuk kanë marrë masa për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për monitorimin dhe mbrojtjen e aktiveve të shoqërisë dhe nuk janë kryer kontrole për llogaritjen e konsumit real të karburantit. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit*" i ndryshuar, Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*" i ndryshuar si dhe pika 5, pika 10, pika 19, pika 35 germa a, b, c, pika 36, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar.

1.1 Rekomandimi: Porti Detar Vlorë, Zyra e Administrimit Financiar, Dega Teknike dhe Investimeve, të marrë masat për monitorimin e shpenzimeve të karburantit, në mënyrë kronologjike, me qëllim përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të tij. Nga Dega Teknike dhe Investimeve, në kartelat përkatëse të automjeteve të evidentohen dhe përditësohen të gjitha të dhënat si dhe të kryhet ky riparimi në automjetet në të cilat janë konstatuar defekte në aparatet e kilometrazhit.

Menjëherë

C. PAGESA TË KRYRA NË MËNYRË JO TË RREGULLT

(për punime të pakryera në momentin e likuidimit)

1. Gjetje nga auditimi (*sipas gjetjes 1 të Masave për pagesat e kryera në mënyrë jo të rregullt*):

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për objektin "*Zgjerimi i Terminalit të Portit Detar Vlorë SHA*", është lidhur kontrata bazë me nr. 776 prot., datë 23.12.2016 mes AK Porti Detar Vlorë SHA, e përfaqësuar nga Titullari z. Admir Malaj dhe sipërmarrësit të punimeve "*JUNIK*" ShPK, e përfaqësuar nga administratori z. Ded Malutaj me vlerë të kontratës 212,638,360 lekë pa TVSh ose 249,186,632 lekë me TVSh si dhe kontrata shtesë me nr. 520/3 prot., datë 26.10.2018 mes AK Porti Detar Vlorë SHA, e përfaqësuar nga Titullari z. Admir Malaj dhe sipërmarrësit të punimeve "*JUNIK*" ShPK, e përfaqësuar nga administratori z. Ded Malutaj me vlerë të kontratës 19,627,350 lekë pa TVSh ose 23,082,812 lekë me TVSh.

Duke qenë se në auditimin e mëparshëm, zbatimi i kësaj kontrate është audituar për pjesën progresive deri në fund të periudhës objekt auditimi (deri më 31.10.2017) pasi ka rezultuar në proces, në vijim paraqiten konstatimet vetëm për periudhën objekt auditimi. Konkretisht rezultoi se janë situacionuar nga sipërmarrësi punime të pakryera në fakt në momentin e situacionimit në shumën 44,214,972 lekë pa TVSh. Nga këto **rezulton e likuiduar për punime të pakryera në fakt në momentin e likuidimit shuma 37,165,900 lekë pa TVSh**. Situacionimi dhe likuidimi i punimeve të pakryera në fakt në momentin e likuidimit të tyre, përbën një veprimtari krejtësisht fiktive dhe është fenomen diskriminues për OE të tjerë, për sa kohë pagesa të tilla nuk janë

parashikuar në formë të rregullt ligjore si parapagime në Dokumentet Standarde të Tenderit. Gjithashtu, veprime të tilla fiktive denatyrojnë krejtësisht procesin e prokurimit pasi vetë AK, në zbatim të LPP dhe RrPP vendos kriter në lidhje me kapacitetet teknike dhe ekonomike që duhet të kenë OE pjesëmarrës në procedurat e prokurimit kur në fakt, siç edhe është shprehur më sipër, një pjesë e pagesave pjesore kryen për punime të situacionuara por të pakryera ende në fakt. Kjo praktikë pagese është konstatuar edhe në auditimin e mëparshëm, ku pagesat për këtë kontratë kanë qenë në fillim të punimeve, por që me këtë formë pagese ka vijuar deri në përfundim të saj. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”* të ndryshuar, neni 1, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3, Udhëzimi nr. 2 datë 13.05.2005 *“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”*, Kreu II, pika 8, Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 07 prot., datë 06.01.2017 si dhe Urdhri i Titullarit nr. 101 datë 20.03.2018 për monitorimin e zbatimit të kontratës.

1.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës i Portit Detar Vlorë SHA të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive në lidhje me pagesën e kryer për punime të situacionuara e të likuiduara dhe njëkohësisht të pakryera në fakt në momentin e likuidimit. Gjithashtu, të rrisë efektivitetin e monitorimit të kontratave me qëllim shmangien e pagesave për punime të tilla.

Menjëherë

D. MASA ADMINISTRATIVE:

D/1. Për Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes Territorit (IKMT) (sipas pikës E. 1 të Masave për Administrative).

- Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”* i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”* i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar, mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 *“Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”*, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*, **i rekomandojmë**, Portit Detar Vlorë SHA, t'i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Vlorë, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe **të vendosë masë administrative me gjobë:**

1. Subjektit **“IMES - D” ShPK** me përfaqësues ligjor Ibrahim Dragoshi, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1641/6 në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve;

2. Subjektit **“GOLD CONSTRUCTION”** me përfaqësuese ligjore Diana Progri, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1945/11 datë 23.03.2018 në cilësinë e kolaudatorit të punimeve;

për shkeljet e konstatuara në zbatimin e punimeve të investimit me objekti **“Zgjerimi i Terminalit të Portit Detar Vlorë SHA”**.

Shënim: Të gjithë punonjësit që atakohen në këtë projekt raport auditimi duhet tu bëhen prezent mangësitë dhe problemet për të cilat mbajnë përgjegjësi, mundësisht tu jepen fotokopje të

dokumentacionit që ka lidhje me ta, në mënyrë që të njihen dhe të bëjnë komentet dhe shpjegimet përkatëse, nëse kanë.

Pjesë e këtij Projektraport auditimi është edhe akt konstatimi nr. 1, datë 19.02.2021, cili është dorëzuar në zyrën e protokollit të Drejtorisë tuaj me nr. 109/2 prot, datë 19.02.2021.

“Për sa më sipër paraqitet ky Projektraport Auditimi”.

GRUPI I AUDITIMIT

Jonild Hoxhaj

Ina Sokoli

Eduart Stafasani

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

Yllka PULASHI

ANEKSE

Aneksi 1
Përmbledhëse e masave sipas llojit.

Në 000/lekë

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Papranuar subjekti		Shkalla e pranimit		Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq	
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera %	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetj a	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
1	Masa organizative	34	-	28	-	6	-	82	-	19	-	5	-	0	-	-	-	4	-	-	-
2	Masa shpërbim dëmi	5	3,935	5	3,935	0	0	100	3,935	2	133	2	3,774	1	27.6	133	0	0	0	1	27.6
3	Mos efekt/e/efic/ekon (3-E)	4	6,086	4	6,086	-	-	100	6,086	3	5,273	1	813	-	-	-	-	-	-	-	-
	Nga të cilat pa kontabilizuar	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
4	Mungesë të ardhurat	1	900	1	900	-	-	100	900	1	900	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Nga të cilat pa kontabilizuar	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
5	Masa disiplinore	9	-	8	-	1	-	89	-	8	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	- Me Status Nëpunësi Civil	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	- Me kontratë pune	9	-	8	-	1	-	89	-	8	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
6	Masa Administrative	5	-	5	-	-	-	100	5	3	-	2	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	- Nga APP	3	-	3	-	-	-	100	3	3	50	-	-	-	-	35	15	-	-	-	-
	Nga të cilat pa kontabilizuar	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	-Nga IMTV	2	-	2	-	-	-	100	2	-	-	2	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Nga të cilat pa kontabilizuar	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
7	Paligjshmëri në procedurat e prokurimit	1	6,086	-	-	1	6,086	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
8	Pagesa të kryera në mënyrë jo të rregullt	1	37,166	1	37,166	-	-	100	37,166	-	-	-	-	-	-	-	-	1	37,166	-	-
TOTALI		60		52		8		86.7		36		10		1		168	133	5		1	27.6

Aneksi 2
Pasqyra e Masave Organizative

Nr	Rekomanduar		Pa pranuar		Pranuar		Nga të pranuarat			
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Zbatuar	Në proces	Pa zbatuar	
1	34	-	6	-	28	-	19	0	-	-

Aneksi 3
Pasqyra e Masave Shpërblim Dëmi

Në 000/lekë

Nr. Rekomandimesh	Emri shkelësit	Vlera Rekomanduar lekë	Pranuar	Nuk pranohen nga subjekti	Nga të pranuarat					
					Zbatuar		Në proces		Pa zbatuar	Në proces gjyqësor
					Nr/datë	Vlerë	Nr/Datë	Vlera		
1	"Denisa Breshaj"/ "Mer ylin 2012"	27	1	-	-	-	-	-	-	1
2	"JUNIK" ShPK	1,368	1	-	-	-	-	-	-	-
3	"JUNIK" ShPK	2,406	1	-	-	-	-	-	-	-
4	"IRIS" ShPK	73	1	-	14.04.2020	73	-	-	-	-
5	ABI BANK	60	1	-	nr. 85/38 prot., datë 09.06.2020	60	-	-	-	-

Aneksi 4
Pasqyra e Penaliteteve nga APP/IMTV Dhe Mbikëqyrësit (Masa Administrative)

Masa administrative rekomanduar nga KLSH	Rekomanduar		Zbatuar		Pa zbatuar		Pjesërisht		Në proces Gjyqësor	
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
1. Gjopa nga IMTV	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
2. Gjopa të APP	3	-	1 person 50,000 lekë 2 persona 0 lekë	-	-	-	-	-	-	-
3. Gjopa mbikëqyrës/ kolaudator	2	-	-	-	-	-	2	-	-	-
TOTALI	5	-	3	-	-	-	2	-	-	-

Aneksi 5
Përmbledhëse e Masave Disiplinore

Masa disiplinore rekomanduar nga KLSH	Rekomanduar	Zbatuar	Pa zbatuar	Në proces Gjyqësor
-Masa disiplinore bazuar në ligjin për statusin e nëpunësit civil	-	-	-	-
1. Largim nga shërbimi civil	-	-	-	-
2. Mbajtje pagës deri në	-	-	-	-
3. Mos ngritje në detyrë për një afat	-	-	-	-
4. Vërejtje.....	-	-	-	-
-Masa disiplinore bazuar në kodin e punës	9	8	1	-
1. Në kompetencë të Këshillit Mbikëqyrës	1	0	1	-
2. “Vërejtje me shkrim” deri në “Largim nga detyra”	8	8	-	-
TOTALI	9	8	1	-

